

Dr. Vehbetu Zuhejli

Ixhtihadi

XVII

Pjesë e shkëputur nga “Usuli fikhu islam”

Autori:
Dr. Vehbetu Zuhejli

Përktheu:
Dr. Musli Vërbani

Titulli:
Ixhtihadi

Korrektura:
Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Hyrje

Që nga vdekja e Muhamedit a.s. deri në mes të shek. të IV hixhrij, ixhtihadi ka qenë çështje e natyrshme, ka pasur shtrirje, ka pasur faktorët e lulëzimit dhe zhvillimit të ligjësimit islam, u është përgjigjur nevojave të njerëzve dhe zhvillimit shoqëror, ka prodhuar revolucion të madh të fikhut, revolucion çfarë nuk njeh historia.

Pastaj, pas shek. të IV hixhrij, ixhtihadi është bërë çështje shumë e vështirë, vështirësi të cilën e shkaktuan dijetarët e mëvonshëm, si rezultat i ndarjes së vendeve islame dhe shkëputjes së lidhjeve ndërmjet umetit dhe dobësimit të lidhjeve të tyre. Kjo është bërë që të vendoset pengesa para atyre të cilët nuk ishin kompetent për ixhtihadë dhe për hulumtim, dhe të ndërpriteshin rrugët e sekteve dhe medhhebeve, të cilat veçse u shumëfishuan, dhe kështu dëshirohej që të mbrohej umeti nga ndarja në fe, andaj e mbyllën derën e ixhtihadit. Muxhtehidët u ndanë në kategori:

- **Kategoria e muxhtehidit absolut;**
- **Kategoria e muxhtehidëve të medhhebit;**
- **Kategoria e muxhtehidëve të çështjeve;**
- **Pas tyre në radhë vijnë muxhtehidët pasues.**

Prej faktorëve të mbylljes së ixhtihadit është heshtja e lëvizjeve të fikhut dhe ngurtësimit të dijetarëve dhe dobësimit të lirisë ideore, si dhe paraqitja e idesë së pasimit. Në mendjet e njerëzve dominoi ideja se për të arritur nivelin e ixhtihadit është bërë e vështirë dhe e pamundur. Kështu, ata menduan se dhuntitë dhe aftësitë e tyre nuk mund të arrijnë në nivelin të cilin janë ngritur imamët e katër medhhebeve, pra, të Imam Ebu Hanifes, Malikut, Shafiiut dhe Ahmedit, dhe imamët e ngjashëm me to prej medhhebeve më pak të njohura si, dhahirijët, ibadijet, shiitët imamij dhe shiitët zejdi, andaj pasoi përmbajtja e çdonjërit në ndonjë medhheb të caktuar, ose për ta kënaqur veten e tyre, ose për shkak të kushteve jetësore, ose për shkak të situatave të caktuara politike.

Mirëpo, pas errësirës së natës, patjetër se do të vjen edhe drita e ditës. Pas mbulimit të qiellit me mjegullat e dendura, patjetër se mjegullat një ditë do të shpërndahen dhe do të shkëlqej qielli dhe atëherë do të ndryshojnë mendimet, do të zgjohet liria e mendimit në thellësinë e atyre të cilët merren me fikh sepse ani pse ka qenë mirë që të mbyllet dera e ixhtihadit për t'u ruajtur uniteti fetar i umetit islam dhe që të sigurohet thesari fikhorë i vjetër, por përveç kësaj kanë rezultuar edhe të këqija të tjera të shumta, e më të rëndësishmet prej tyre janë:

- **Mbetja e fikhut islam në kohën e kaluar;**
- **Zmbrapsja e njerëzve nga ligjet e sheriatit;**
- **Mbështetja e njerëzve për çështjet praktike në kushtetutat e perëndimit, si në aspektet politike, ekonomike, në çështjet shoqërore dhe të marrëdhënieve reciproke,** gjë që qoi deri te mosgjetja e një forme të sistemit shoqëror dhe civil, ndryshoi opinionin ynë dhe teoritë tona të kushtetutave dhe filluan idetë dhe pretendimet e reformimit në vetvete, filloi shfuqizimi i vet sunetit sipas mendjes dhe e interpretuan Kur'anin në bazë të epshit dhe në bazë të kandarit të mendjes së tyre, duke shikuar interesin e njerëzve vetëm sipas ideve të tyre dhe dominimit të rrethanave shoqërore.

- **Kush e ka mbyllur derën e ixhtihadit?**
- **A mundet ndonjëri të thotë se ka dhunti prej Zotit dhe aftësi të kufizuara të një gjenerate kundrejt gjeneratës tjetër, ose të një njeriu kundrejt një njeriu tjetër.**

Për këtë arsye, pretendimet e mbylljes së derës së ixhtihadit janë të pabaza, sepse prej domosdoshmërive të përfundimit të ligjeve qiellore me sheriatin islam është hapja e derës së ixhtihadit për të vepruar çka të dëshirohet. Kanë pasur të drejtë shiitët dhe lëvizjet e selefijëve bashkëkohor kur kanë thënë se dera e ixhtihadit është e hapur, ashtu siç kanë të drejtë të tjerët prej dijetarëve të sunetit, si f.v., Es-Sujutiu, i cili e ka shkruar librin të cilin e ka titulluar **“Përgjigje për atë i cili është i përgjithmonshëm në tokë dhe e injoron faktin se ixhtihadi është farz për çdo gjeneratë.”** dhe e ka ndarë në katër kapituj.

Në kapitullin e parë i ka përmendur mendimet e dijetarëve se ixhtihadi është farz për çdo gjeneratë prej farzeve kolektive dhe nuk lejohet që një gjeneratë të mos ketë ixhtihadë. Në temën e shtatë do t'i përmendi disa prej atyre mendimeve, dhe do të shpejtoj që tani, që të tregoj se çka ka shkruar Sujutiu në këtë libër, citoj:

“Njerëzit i ka kapluar injoranca dhe i ka verbëruar. Duke qenë kokëfortë janë verbëruar, saqë e kanë ekzagjeruar pretendimin e ixhtihadit, duke e llogaritur si çështje e mohuar prej njerëzve dhe këta injorantë nuk e ndjejnë se ixhtihadi është farz prej farzeve kolektive të çdo epoke dhe është obligim për banorët e çdo kohe që të ngrihet një grup nga çdo pjesë e tokës (për të bërë ixhtihad).”

Shevkaniju thotë:

“Dhe kush e përkufizon dhuntinë e Allahut në vetëm te disa njerëz (gjeneratë) dhe përcakton se, sheriati mund ta kuptojnë vetëm gjenerata e kaluar, ai është larguar nga Allahu i Lartmadhëruar. Pastaj, sheriati është për të gjithë robërit, pastaj robërit e Tij janë ata të cilët e adhurojnë Allahun me librin e tij dhe me sunetin e të dërguarit të Tij.”¹

Ixhtihadin do ta sqarojmë si në vijim:

Tema e parë: Definicioni i ixhtihadit, sqarimi i ligjësimit dhe llojet e tij.

Tema e dytë: Kushtet e ixhtihadit.

Tema e tretë: Sfera e ixhtihadit.

Tema e katërt: Dispozita e ixhtihadit dhe disa çështje të cilat rezultojnë prej saj.

Tema e pestë: Ixhtihadi i pjesshëm.

Tema e gjashtë: Kategoritë e ixhtihadit.

Tema e shtatë: Hapja dhe mbyllja e dyerve të ixhtihadit.

Tema e tetë: Gabimi dhe mosgabimi në ixhtihadë.

Tema e nëntë: Rruga e ixhtihadit.

Tema e dhjetë: Kundërshtimi i ixhtihadit.

Tema e parë: Definicioni i ixhtihadit, sqarimi i ligjësimit dhe llojet e tij

E para: Definicioni i ixhtihadit

Ixhtihadë – gjuhësisht është shprehje e harxhimit të mundit dhe shpenzimi i çdo mundësie në realizimin e një çështje prej çështjeve, dhe ky term përdoret vetëm në kuptim të asaj *që sjell lodhje dhe vështirësi*. Thuhet: Është lodhur dhe është rraskapitur në bartjen e gurit të madh, dhe nuk thuhet: Është lodhur dhe rraskapitur në bartjen e kokrrës së bizeles.

Në terminologjinë e dijetarëve të usulit, në kuptimin e saj të përgjithshëm, ka shumë definicione:

1. Amediu dhe autori i librit “Muslimu thubut” dhe një grup i dijetarëve e definojnë kështu:² **“Shpenzimi i të gjitha mundësive në kërkimin e një çështjeje presupozuese prej ligjeve të sheriatit, deri në atë masë sa që njeriu e ndien se nuk mundet më shumë për të arritur deri te ajo çështje.”** Ky është definicioni i Amediut dhe autorit të librit “Muslimu thubut”, ngjashëm me të dhe i përafërt, është edhe definicioni i Ibni Haxhibit: **“Shpenzimi i fuqisë nga fekihi për të përfutuar ligj sheriatik jo të prerë.”**

Mirëpo, definicioni është kritikuar sepse nuk i përmbledh të gjitha njësitet që e meritojnë të jenë pjesë e definicionit, pasi që nuk përfshihet dituria për ligjet, dhe se nuk ka pengesë që të përfshihen në definicion edhe termi “çështje të panjohura”, përderisa përfshirja e termit “presupozuese” nuk është e drejtë të përfshihet edhe pse nuk është argument i sheriatit.

Definicioni mund të përmirësohet me atë se qëllimi është për çështje **“jo të prerë absolute”** e cila përmban dituri (njohuri) dhe që qëllimi të jetë me “jo të prerë” me argument: Është ajo që të llogaritet ligj legjitim vetëm se duhet të mbetet në definicion përsëritja e pjesës “shpenzimi i energjisë” me pjesën tjetër të definicionit “në atë mënyrë që të ndihet i paaftë që të shtojë më shumë”. Definicioni duhet të mos ketë përsëritje dhe turbullti.

2. Gazaliu, dhe disa dijetarë tjerë, e prej tyre edhe Hudarij, e definojnë kështu:³ **Shpenzimin e energjisë dhe të gjitha mundësitë duke kërkuar dituri për ligje të shariatit.**

Edhe ky definicion është kritikuar, sepse rezultati (produkti) i ixhtihadit nuk përkufizohet me ligjet e sigurta, përkundrazi, shumica e tyre janë jo të sigurta, pos nëse definicioni me fjalën “dituri” ka për qëllim diturinë më gjithëpërfshirëse se dituria e sigurt dhe dituria jo e sigurt.

3. Disa fukaha e definojnë kështu: **Ixhtihadi është kijasi.** Gazaliu thotë se ky definicion është i gabuar sepse ixhtihadi është më gjithëpërfshirës se kijasi sepse ndonjëherë studiohen të përgjithshmet dhe imtësitë e fjalëve dhe të gjitha rrugët tjera të argumentimit përpos kijasit.⁴

4. Nga të gjitha definicionet që janë raportuar, sipas mendimit tonë definicioni më adekuat është ai të cilin e ka përmendur Bejdaviju:⁵ **Ixhtihadi është zbrazja e energjisë për të perceptuar ligjet e shariatit.**

Fjala “zbrazje” nënkupton shpenzimin e mundit dhe energjisë.

Fjala “perceptim i ligjeve” është më gjithëpërfshirëse se fjala “në mënyrë të prerë”, ose jo të prerë.⁶

I ngjashëm me këtë definicion është definicioni i Ibni Hemamit dhe disa tjerëve të cilët e definojnë si në vijim:⁷ **“Ixhtihadi është harxhimi i fuqisë nga fekihi, për të përpiluar një ligj shariatik, pa marrë parasysh a është logjik apo transmetues, i prerë apo jo i prerë.”**

Definicioni përfshinë ixhtihadin në çështje logjike dhe transmetuese, qofshin të prera apo jo të prera.

Nga definicioni përjashtohen ata të cilët nuk janë fekihë, sepse nëse personi nuk është fekih, te dijetarët e usulit nuk quhet ixhtihadë, siç nuk quhet hulumtimi i rregullave gjuhësore, ose rregullave logjike dhe praktike (lëndore) nga dijetari i cili nuk është fekih.

Përfundim – ixhtihadi është proces i përpilimeve të sheriatit nga argumentet parcialetë saj.⁸

E dyta: Ligjësimi i ixhtihadit

Shumë argumente e dëshmojnë se, ixhtihadi, si bazë prej bazave të sheriatit është i lejuar, ose nëpërmjet rrugëve të qarta, ose nëpërmjet rrugëve sinjalizuese.

Prej argumenteve të ixhtihadit janë: Çka e tregon Kur’ani fisnik.
Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ لِتَحْكُمَ بَيْنَ النَّاسِ بِمَا أَرَاكَ اللَّهُ

“Ne të zbritëm ty (Muhammed) librin (Kur’anin) me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi All-llahu...”(En-Nisa : 105)

Ky ajet përmban konfirmimin e ixhtihadit nëpërmjet kijasit.⁹

Po ashtu, në një ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë:

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ

“Vërtet, në gjithë këtë ka fakte për njerëzit që thellë mendojnë.”
(Er-Rread : 13)

“Edhe kjo dëshmon për argumente për njerëzit e mençur.” (Err-Rread : 14)¹⁰

Edhe hadithet dëshmojnë lejimin e ixhtihadit, prej tyre:

Argumentimi i Shafiut r.a.¹¹ nga Amr bin Asi se e ka dëgjuar pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

“Nëse gjykatësi gjykon, dhe bën ixhtihadë, dhe ia qëllon, meriton dy shpërblime, por nëse gjykon duke bërë ixhtihadë dhe gabon, ai meriton një shpërblim.”¹²

Hadithi tjetër:

Kur pejgamberi s.a.v.s. e ka dërguar Muadhin si kadi në Jemen, dhe e ka pyetur:

- Me çka do të gjykosh?

Muadhi i është përgjigjur: - Me atë çka është në librin e Allahut.

Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: - Po nëse nuk e gjen në librin e Allahut?

(Muadhi) Përgjigjet: - Gjykojmë me atë çka ka gjykuar i dërguari i Allahut.

Pejgamberi a.s. i thotë: - Po nëse nuk e gjen në atë çka ka gjykuar i dërguari i Allahut?

Muadhi i përgjigjet: Do të bëj ixhtihadë me mendimin tim.

Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: - Falënderoj Allahun, është në harmoni me të dërguarin e Tij.”¹³

Sehabet e kanë vazhduar rrugën e ixhtihadit në çështje të cilat nuk i kanë ditur nga Kur’ani dhe suneti. P.sh., Ebu Bekrit kur i ndodhte ndonjë çështje të cilën nuk e shihte se është në librin e Allahut dhe as në sunetin e të dërguarit të Allahut, ai bënte ixhtihadë.¹⁴

Janë dakorduar sehabet, sepse kur u ndodhte ndonjë ndodhi e sheriatit, dhe shtrohej çështja se a është haram apo hallall, dhe e shihnin se nuk është as në Kur’an dhe as në sunet, dhe nuk kishin ndonjë informatë për atë ndodhi, menjëherë shpërndaheshin për të bërë ixhtihadë për atë çështje.¹⁵

E treta: Llojet e ixhtihadit

Imam Shafiiu, ixhtihadin e ka përkufizuar në kuptimin e përpilimit të ligjeve në analogji të një çështjeje e cila gjendet në Kur'an apo sunet. Kur një person e ka pyetur:

-Ç'është ixhtihadi?

Është përgjigjur: - Ixhtihadi është kijasi.

-Mos dallojnë në mes vete? Ka pasuar pyetja.

-Ato janë dy çështje të një kuptimi. – Është përgjigjur.¹⁶

Ai e ka përkufizuar ixhtihadin në kuptimin e veçantë për ixhtihadin dhe nuk i jep kuptimin e ndonjë argumenti tjetër të cilin e parashohin dijetarët e umetit. Kurse dijetarët i japin kuptim më të gjerë ixhtihadit.

Dijetarët i japin kuptimin *gjithçka që përfshihet në mendje*, pra i japin kuptimin e kijasit dhe të mendimit logjik.¹⁷

Ashtu siç e kanë kuptuar sehabet, e po ashtu edhe dijetarët, ixhtihadi është proces të cilin e parashih muxhtehidi se është më afër shpirtit të ligjësisimit islam duke mos shikuar se a është ndonjë bazë e caktuar e ngjarjes apo nuk është bazë e caktuar e asaj ngjarjeje.¹⁸

Duke vërejtur kuptimin më të gjerë të ixhtihadit, doktori i njohur Devalibiju e ndanë ixhtihadin në tri lloje,¹⁹ të cilat Shatibiju i ka treguar disa prej tyre në librin “Muvafekat”.²⁰

1. **Ixhtihadi sqarues** – kjo nga shkaku se i sqaron ligjet e sheriatit nga tekstet e Ligjvënësit.

2. **Ixhtihadi analogues** – kjo nga shkaku se i vendos ligjet e sheriatit mbi ngjarjet të cilat ndodhin të cilat nuk janë as në Kur'an dhe as në sunet dhe analogohen me ngjarjet të cilat janë në tekstet e sheriatit, të cilat kanë prodhuar ligje.

3. **Ixhtihadi terminologjik** – gjithashtu vendosen ligjet e sheriatit në ndodhinë e cila nuk është as në Kur'an dhe as në sunet dhe analizim me logjikë, të cilat bazohen në rregullin terminologjik. Profesori Muhamed Tekijul – Hakijm e ka replikuar në tri çështje:²¹

1. **Nuk i përfshinë të gjitha kushtet e llojeve të cilat janë kushte logjike**, sepse nuk përfshihen nënlojet e llojeve. Ai nuk e përfshinë ixhtihadin e istihsanit dhe llojet tjera të ngjashme të cilat janë argumente për përpilim ligjesh të cilat i praktikojnë fukahatë, që disa i kanë numëruar deri në nëntëmbëdhjetë lloje, lloje të cilat i ka përmendur Tufi në “Risalen” e tij. Atë e ka pasuar shejh Xhemalud-dijn el Kasimiju i cili i ka përmendur dyzetë e një argumente.

2. **Kijasi nuk është në të gjitha llojet të cilat janë lloje të ixhtihadit sqarues, por vetëm në disa prej tyre**, si f.v., kijasi me tekstin arsyetues i cili përfitohet nga përgjithshmëria e tekstit ose papërcaktueshmëria e tekstit me arsyetimin e përgjithshmërisë së ligjit me të gjitha çështjet me të cilat ndërlidhen me to dhe as të parimit të interesit, i cili në bazë të definicionit të Devalibijut bën pjesë në ixhtihadin sqarues të cilat përfitohen nga argumentet e përgjithshme. Shembull: **“Mos dëmtoni dhe mos u dëmtoni.”**

3. **Ka dallim në mes të rrugës së ixhtihadit sqarues dhe dy rrugëve tjera**, duke pasur parasysh se njëra është sqarues i ligjeve të sheriatit, ndërsa rruga e dytë dhe e tretë përpilues i atyre ligjeve. Në bazë të kësaj, patjetër se muxhtehidi duhet llogaritur si ligjësues, por ai është jashtë kornizës së ixhmait të muslimanëve, nëse kësaj ia shtojmë kritikën e tij (kritikën e Devalibiut) ku të gjitha zbulimet i llogaritë ligje të sheriatit.

Edhe pse kjo ndarje (e llojeve) nuk shpëton nga kritikata, profesori Hakijm e ndanë në dy lloje.

Ixhtihadi logjik – është ixhtihadi i cili është argument i konfirmuar nga burimet e pastra logjike, por që nuk merret me legjislativ, si f.v., çështje logjike të pavarura, dhe rregullat se duhet të largohet dëmi në bazë të mundësisë dhe dënimi i të keqes pa sqarim, etj.

Ixhtihadi sheriatik. Ajo çka ka nevojë që të bëhet argument i tij prej argumenteve të sheriatit. Në këtë lloj të ixhtihadit bëjnë pjesë: ixhmai, kijasi, istihsani, istis’habi, parimi i interesit, etj.

Tema e dytë: Kushtet e ixhtihadit

Shprehjet e autorëve ndryshojnë në përcaktimin e rrugëve të ixhtihadit, mirëpo në përmbajtjen e saj janë një, por me disa dallime të thjeshta (të vogla).

Sipas Gazaliut: Për të qenë muxhtehidë kushtëzohen dy kushte:²²

Kushti i parë: Që të ketë përfshirje në perceptimin e ligjit, ashtu që të ketë aftësi që me mendjen e tij të ketë ndikim në hulumtim, saqë t'i jep përparësi asaj që duhet t'i jepet përparësi dhe të vonoj atë që duhet lënë mbrapa.

Kushti i dytë: Të jetë i drejtë, që të jetë larg mëkateve që shkaktajnë padrejtësi nga ana e tij, sepse ai i cili është i padrejtë, nuk i pranohet fetvaja, edhe pse në esencë (praktikisht) mund të bëjë ixhtihadë, prapëseprapë ky nuk është kusht që ai të lejohet të merret me ixhtihadë.

Shatibiju e shpreh kështu:²³ Nivelin e ixhtihadit e arrin ai i cili cilësohet me dy cilësi:

E para: **Që plotësisht t'i kuptoj objektivat e sheriatit.**

E dyta: **Aftësia për të përpiluar ligj duke u bazuar në kuptimin e objektivave të sheriatit.**

Si e shpreh Amediu dhe Bejdaviju? ²⁴

Për muxhtehidin kushtëzohen dy kushte:

E para: Të jetë i ngarkuar dhe besimtar në Allahun dhe në pejgamberin e Tij.

E dyta: Që të jetë i ditur dhe të ketë njohuri për t'i perceptuar ligjet e sheriatit dhe llojet e tij dhe rrugët e ligjësimit, dhe formën e tregueshmërisë prej argumenteve.

Këto mendime dhe të ngjashme me to, mund t'i elaborojmë dhe t'i caktojmë kushtet si në vijim,²⁵ dhe atë se kush duhet të arrij nivelin e ixhtihadit:

E para: Që personi t'i kuptoj kuptimet e ajeteve legjislative të përmendura në Kur'anin fisnik, gjuhësisht dhe ligjërisht.²⁶ Nuk kushtëzohet të mësohen përmendësh, dhe as që të mësohet përmendësh i tërë Kur'ani, por mjafton që të dijë vendin e tyre ashtu që të kthehet te ato vende kur të kërkohet nevoja. Gazaliu, Raziu dhe Ibni Arabij²⁷ i kanë paraparë se numri i ajeteve legjislative është pesëqind ajete.

Shevkaniju thotë: “Mendimi i përkufizimit deri në këtë nivel është vetëm nga aspekti i jashtëm, për të krijuar bindje të sigurt se në Kur'anin fisnik ekzistojnë ajetet prej të cilave prodhohen ligje të panumërta, bile ai i cili ka perceptim të drejtë dhe analizë të plotë mund të nxjerrë ligje nga ajetet e Kur'anit të cilat tregojnë vetëm shembuj dhe tregime. Është thënë, se me ato ajete (të tregimeve dhe shembujve) qëllimi është të tregohet për ligjet të cilat kanë prioritet në vete, por jo për detyrim dhe obligim.”

Përderisa, sa i përket kuptimit të ajeteve gjuhësisht, ky kusht plotësohet duke ditur fjalët veç e veç, fjalitë përbërëse, specifikat e fjalëve se çfarë kuptimi kanë, ose nëpërmjet bazës së saj burimore arabe, ose nëpërmjet mësimit të rregullave të gjuhës arabe, si mësimi të gramatikës, sintaksës, morfologjisë dhe shkencave tjera gjuhësore.

Sa i përket njohurisë legjislative, duhet që t'i dijë arsyet dhe kuptimet të cilat ndikojnë në ligje, format treguese të fjalëve në kuptim, si nga të shprehurit e fjalës, tregueshmërisë së fjalës, apo anulimit retorik të fjalës ose tregueshmërisë shprehimore ose tregueshmërisë kuptimore. Njohuria e llojeve të fjalëve si, fjala e përveçme, fjala globale, fjala interpretuese, etj.²⁸

E dyta: Që t'i dijë hadithet ligjore dhe hadithet tekstuale, siç i sqaruar më herët. Nuk është e domosdoshme t'i dimë përmendësh të gjitha hadithet e sunetit, por nevojitet që të ketë mundësi që të kthehet te ato hadithe kur të përpilon ndonjë ligj, ashtu që t'i dijë vendet e hadithit në bazë të indeksit. Ibn Arabiu e ka përcaktuar numrin prej tre mijë haditheve. Raportohet se Ahmed bin Hanbeli ka thënë: Bazat me të cilat sillet njohuria për hadithet e pejgamberit s.a.v.s. duhet të arrij shifrën e njëmijë e dyqind haditheve.²⁹

Sipas mendimit tim, ashtu siç e kemi vërejtur te çështja e Kur'anit që numri nuk është i saktësuar, po ashtu edhe hadithet me përmbajtje ligjore janë të shumta dhe janë të shpërndara në libra të ndryshme (andaj vështirë se mund të saktësohet numri).

Shevkaniu ka thënë:³⁰ “Nuk ka hamendje dhe nuk ka dyshim se, muxhtehidi patjetër duhet të dijë çka përmbajnë koleksionet të cilat i kanë përmbledhur ekspertët e kësaj fushe, siç janë gjashtë koleksionet bazë: Sahihu i Buhariut, Muslimit, suneni i Ebu Davudit, Termidhiut, Nesaiut dhe Ibni Maxhes, dhe koleksionet tjera të rëndësishme (suneni i Bejhekiut, Darukutnijut dhe Darumijut) duke pasur në konsideratë se çka përmbajnë musnedet, regjistrat dhe librat, autorët e të cilave i kanë paraparë se janë të sakta (*shembull, sahihu i Ibni Huzejmes, sahihu i Ibni Habanit, sahihu i Hakim Nisaburit*), ashtu që muxhtehidi të mos i qaset mendimit të tij, ose kijasis, kur veçse ekziston teksti. Kjo ka të bëjë me përmbajtjen e hadithit.

Po ashtu, nevojitet të dihet senedi i hadithit, e cila është rruga e cila e ka sjellë deri tek ne, si hadithet “mutevatir”, hadithet “meshhur” dhe hadithet “ahad”, dhe nevojitet që të dinë personalitetin e transmetuesve, drejtësinë, të metat e tyre, në mënyrë që ta dalloj hadithin e saktë nga i dobëti. Nuk kushtëzohet që t'i dijë transmetuesit thellësisht, por llogaritet se duhet të dijë aq sa i nevojitet të kuptoj në librat e hadithit, për të metat dhe drejtësinë e transmetuesve.

Duke pasur parasysh se hulumtimi i identitetit të transmetuesve në kohën e sodit është pothuajse i pamundur, për shkak të largësisë së gjatë kohore deri tek ata, mjafton që të llogariten të drejtë nga dijetarët e umetit të cilët janë pajtuar në shkencën e hadithit siç janë, Buhariu, Muslimi, Begaviju, dhe dijetarët e tjerë të shkencës së hadithit.³¹

E treta: Njohuria e shfuqizimit dhe të shfuqizuarës në Kur'an dhe në sunet,³² pra, posaçërisht të ajeteve dhe të haditheve, ashtu që muxhtehidi të mos bazohet në ligjin e shfuqizuar i cili nuk është aktiv pasi që aktiv është ligji shfuqizues, sepse bën ixhtihadë në atë çka është e pavlefshme. Mjafton që të kthehet në librat e kësaj teme, shembull, libri i Ibni Huzejmes, libri i Xhaëfer en-Nuhasi, libri i Ibni el-Xhevzijut dhe el-Hazimijut, të Ibni Hazmit, të Tahavijut në konceptet e gjurmuara, e të tjera. Nuk kushtëzohet të diturit e të gjithë atyre librave dhe të përmbajturit përmendësh të tyre, por mjafton që për çdo ngjarje të jep fetva për ndonjë ajet apo hadithë ose që ta dijë se ai hadithë apo ajet është i interpretuar.³³

E katërta: Që të ketë aftësi të dijë çështjet e ixhmait dhe vendet tyre (vendimet) ashtu që të mos jep fetva në kundërshtim me ixhmain. Nuk është e domosdoshme që t'i dijë përmendësh të gjitha çështjet unanime dhe çështjet kundërshtuese, por për çështjen të cilën jep fetva, duhet ta dijë se ajo fetva nuk është në kundërshtim me ixhmain, por që është çështje e pajtueshmërisë së një medhhebi i cilit do qoftë, ose duhet që të mbizotëroj mendimi te ai se, ajo ngjarje ka qenë në kohën për të cilën nuk kanë debatuar autoritetet e ixhmait.³⁴ Mjafton që të mbështetet te libri "*Meratibul ixhmaë*" të Ibni Hazmit.

E pesta: Që të dijë format e kijasit dhe rrugën e përpilimit të ligjeve nga tekstet.

Interesat e njerëzve dhe bazat themelore të ligjit sepse kijasi është rregull i ixhtihadit, në të cilën ndërtohen shumë ligje parciale.

Disa janë përcaktuar në atë se ixhtihadi i ka vetëm këto kushte,³⁵ ndërsa unë e shoh të domosdoshme t'i shtoj edhe disa kushte tjera.

E gjashta: Që të dijë gjuhën arabe dhe shkencat e saj të gramatikës, sintaksën, metodat, sqarimet, kuptimet, etj., sepse Kur'ani dhe suneti janë në gjuhën arabe, dhe duhet të dijë fjalët e thjeshta dhe fjalitë përbërëse të gjuhës arabe, nuk lejohet të jap fetva pa i ditur kuptimet e gjuhës, specifikat dhe përmbajtjen e saj, e prej tyre njohuria e ligjit të përgjithshëm, fjalët alegorike, fjala e papërcaktuar dhe e përcaktuar, dispozita e fjalëve

treguese, fjalët e përdorimit të rrallë. Nuk kushtëzohen që këto çështje t'i mësoj thellësisht, por mjafton që të ketë aftësi në përpilimin e ligjeve prej literaturës gjegjëse³⁶ dhe t'i kuptoj ato, si p.sh., libri i autorit Er-Rabi Esfehanijut *“Mufredatul Kur'an”* dhe libri i Ibni Ethirit *“En-Nihajetu fi garibil hadithë vel ether.”*

Me plotësimin e këtij kushti, nuk është qëllimi të arrij nivelin e lartë gjuhësor sikurse të Halilit, Mebretit, e të Esmeijut e të Sibevejhit, dhe as që ta dijë të gjithë gjuhën arabe dhe të jetë i thelluar në gramatikë, por mjafton që të dijë aq sa të ketë aftësi të kuptoj të folurit arab, zakonet e tyre, përdorimin e gjuhës së tyre deri në atë masë sa të dalloj fjalën e qartë, fjalën shumë të qartë, fjalën globale, fjalën në kuptim të drejtë prej fjalës alegorike, fjalën e përgjithshme prej fjalës së veçantë, fjalën e interpretuar dhe fjalën e painterpretuar, fjalën e përcaktuar prej fjalës së papërcaktuar, fjalën tekstuale prej të kuptuarit të fjalës, fjalën e thënë dhe fjalën e kuptuar prej saj, dhe kjo aq sa ka të bëjë në të në lidhje me të kuptuarit e Kur'anit dhe të sunetit dhe të mbizotëroj mënyrën e ligjërimit, perceptimin e fakteve dhe qëllimet prej atyre fjalëve.³⁷

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij kushti, disa³⁸ e kanë paraparë që ky kusht të jetë kushti i parë, sepse njohuria e mjaftueshme dhe cilësore e gjuhës llogaritet sikurse mjeti me të cilën arrihet diçka, kush nuk di të dirigjoj mjetin dhe nuk e di përdorimin e atij mjeti, nuk mund të prodhoj prodhimin me përsosmëri ashtu siç ka thënë edhe Shehrestaniju.

E shtata: Që të jetë i ditur në shkencën e usuli fikhut, pasi që argumenti parcial tregon për ligjin nëpërmjet mënyrës së caktuar,³⁹ si f.v., mënyra urdhërore, mënyra ndaluese, mënyra e përgjithshme, mënyra e veçantë, e të ngjashme, dhe në momentin e përpilimit të ligjit patjetër se duhet të dihen këto mënyra dhe dispozitën e secilës prej tyre. Dhe e gjithë kjo kuptohet prej shkencës së usuli fikhut.⁴⁰

Fahru Rraziju në librin *“El Mahsulë”* thotë: Pa dyshim, prej shkencave më të rëndësishme për muxhtehidin është shkenca e usuli fikhut.

Gazaliu thotë: Pa kurrfarë dyshimi se shkenca më madhështore e ixhtihadit është që të përfshihen tri çështje: Hadithi, gjuha (arabe) dhe usuli fikhu.

Shevkaniju ka tërhequr vërejtjen se: “Nuk mjafton që të dijë çështjet e usulit të cilat i kanë caktuar muxhtehidët, por patjetër duhet të dijë këto baza nga vetja e tij, ashtu siç i kanë perceptuar dijetarët e umetit para se të themelohet shkenca e usulit, dhe që të shikoj në çdo çështje me shikim të pavarur që të arrijë deri te e vërteta⁴¹ dhe të jetë i përgatitur në të kuptuarin e gjuhës arabe dhe të përcjell mënyrat e përdorimit të fjalëve, dhe metodologjinë e prozës dhe poezisë arabe, shkrimin arab, ligjërimin arab, se në të kundërtën ai mund të jetë muxhtehidë brenda kornizës së imamit të një mehdhebi dhe kështu nuk është muxhtehidë i pavarur.”

E teta: Që t’i perceptoj objektivat e përgjithshme të sheriatit⁴² në përpilimin e ligjeve, sepse të kuptuarit e teksteve dhe zbatimi i tyre në një ndodhi varet prej njohurisë së objektivave të sheriatit.

Kush dëshiron që të përpiloj një ligj të sheriatit nga një argument i tij duhet që të dijë sekretet e ligjësimit dhe objektivat e tij të përgjithshme në ligjësimin e ligjeve sepse tregueshmëria e kuptimit të fjalës mund të ketë shumë kuptime dhe i jepet prioritet njërit prej tyre atëherë kur e sheh se ai kuptim pikësynon objektivin e Ligjvënësit.

Ndonjëherë ndodhë një ngjarje e re, për të cilën nuk ekziston ligj në tekstet e sheriatit, atëherë duhet të shkohet te istihsani, ose te parimi i interesit ose te tradita, e të ngjashme, e kjo nëpërmjet objektivave të përgjithshme të sheriatit prej ligjësimit.

Qëllimi në këto opinione është që të sigurohen interesat e njeriut duke u sjellë dobi atyre, ose duke larguar dëmin prej tyre, sepse në mënyrë të vazhdueshme është konfirmuar se vendosja e sheriatit është në interes të robërve edhe për këtë botë edhe për botën tjetër. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

رُسُلًا مُبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ

“Të dërguar, lajmgëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para All-llahut...” (En-Nisa : 165)

Pastaj në ajetin tjetër:

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ

“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” (El-Enbija : 107)⁴³

Nuk mund të fshihet e vërteta se kandari i përcaktimit të së mirës dhe të keqes nuk është ashtu siç e shohin njerëzit, por siç e sheh Ligjvënësi, sepse njeriu ndonjëherë të dëmshmen e sheh si të dobishme dhe e lejon, si p.sh., vjedhjen, ose pirjen e alkoolit, e ndonjëherë të dobishmen e sheh si të dëmshme, si p.sh., dhënien e zekatit e llogarit si pakësim të pasurisë, apo shkuarjen në luftë e sheh si të dëmshme edhe pse në të është dobja e përgjithshme. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَلَوْ اتَّبَعَ الْحَقُّ أَهْوَاءَهُمْ لَفَسَدَتِ السَّمَاوَاتُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ

“E, sikur të përputhej e vërteta me dëshirat e tyre, do të shkatërroheshin qiejt e toka dhe çdo gjë që gjendet në to.” (El-Muëminunë : 71)⁴⁴

Këto janë kushtet e ixhtihadit të cilat shpijnë në konkluzionin e drejtë dhe të plotë.

Vetëm se, siç thotë Gazaliu,⁴⁵ këto kushte kushtëzohen në të drejtën e muxhtehidit absolut, pra në të drejtën e muxhtehidit i cili jep fetva për të gjitha ligjet, dhe sipas mendimit të shumicës absolute të dijetarëve janë kushte për ixhtihadin i cili nuk pjesëzohet - *siç do të shohim në temën* – Lejohet që dijetari ta arrijë gradën e ixhtihadit për disa çështje, dhe jo për disa çështje tjera.

Tema e tretë: Fusha e ixhtihadit

Gazaliu, çështjen e ixhtihadit⁴⁶ e ka përkufizuar në **çdo ligj të sheriatit i cili nuk ka argument të prerë.**⁴⁷

Nga ky definicion përjashtohen çështjet në të cilat nuk bëhet ixhtihadë, pra në çështjet për të cilat janë dakorduar dijetarët prej çështjeve të qarta të ligjësuara, si f.v., obligueshmëria e pesë kohëve të namazit, zekatit, e të ngjashme.

Ligjet e sheriatit për të cilat bëhet ixhtihadë është dy llojesh:

- **Çështje në të cilat nuk lejohet ixhtihadi,**
- **Çështje në të cilat lejohet ixhtihadi.**⁴⁸

Sa i përket çështjeve për të cilat nuk lejohet ixhtihadi janë çështjet e njohura si çështjet e domosdoshme të fesë dhe çështjet e natyrshme, ose çështjet të cilat janë ligjësuara me argument të prerë, si f.v., obligueshmëria e pesë kohëve të namazit, agjërimit, zekatit, haxhit dhe dëshmisë së shehadetit, ndalimi i prostitucionit, vjedhjes, pirjes së alkoolit, vrasjes dhe dënimet e veprave penale të caktuara të cilat dihen prej ajeteve të Kur'anit fisnik dhe të sunetit pejgamberik foljor dhe veprimor. Po ashtu, të gjitha dënimet e veprave penale të përcaktuara, apo kompensimet e përcaktuara. Në këto çështje nuk ka hapësirë për ixhtihadë. Shembull, thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

الزَّانِيَةُ وَالزَّانِي فَاجْلِدُوا كُلَّ وَاحِدٍ مِّنْهُمَا مِائَةَ جَلْدَةٍ

“Laviren dhe lavirin t’i rrihni, secilit prej tyre me nga njëqind të rëna.”
(En-Nurë : 2)

Andaj nuk bëhet ixhtihadi për numrin e shkopimit.

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ

“Falni namazin dhe jepni zekatin,.” (El-Bekare : 43)

Nuk bëhet ixhtihadi për qëllimin e namazit apo të zekatit, pasi që suneti vepror e ka treguar qëllimin prej tyre.

Po ashtu nuk bëhet ixhtihadë për hadithet mutevatir të zekatit.

Çështjet për të cilat lejohet ixhtihadi janë:

- ligjet të cilat burojnë nga teksti jo i prerë dhe me tregueshmëri jo të prerë, dhe
- në ligjet për të cilat nuk ekziston tekst ose ixhmaë.

Nëse teksti është jo i prerë, atëherë në atë tekst bëhet ixhtihadë. Hulumtimi bëhet në zinxhirin e transmetuesve të tij, gradën e transmetuesve, drejtësinë e tyre, saktësinë e tyre. Në këto çështje ndryshojnë muxhtehidët sa i përket përcaktimit të argumentit:

- **disa e pranojnë**, për shkak se janë të bindur në atë argument,
- **disa e refuzojnë** sepse nuk janë të sigurt në rrugën deri te transmetimi, e kjo ndikon në derivimin e mendimeve të ndryshme nga ana e muxhtehidëve për shumë çështje ligjore praktike të fikhut.

Nëse teksti është me tregueshmëri jo të sigurt, ixhtihadi bëhet në hulumtimin për të mësuar se çfarë qëllimi ka ai tekst dhe forcën e tregueshmërisë së atij kuptimi:

- ndoshta teksti është i përgjithshëm,
- ndoshta teksti është i papërcaktuar,
- ndoshta ka për qëllim formën urdhërore, apo ndoshta formën ndaluese,
- ndoshta argumenti udhëzon tregueshmëri në kuptimin nëpërmjet rrugës së shprehjes, apo rrugës sinjalizuese apo rrugëve tjera. E gjithë kjo është fusha e ixhtihadit,
- ndoshta është i përgjithshëm që konsiston të mbetet në tërësinë e tij,
- ndoshta duhet të specifikohet në disa çështje.

Fjala e papërcaktuar, ndoshta duhet të mbetet e papërcaktuar, ndoshta duhet të përcaktohet.

Urdhërori, edhe pse në esencë është për obligueshmëri, ndoshta ka për qëllim lejimin apo edhe se është i pëlqyer ai veprim.

Ndalesori – edhe pse në kuptim të drejtë tregon për ndalesën, ndonjëherë tregon se është çështje e urryer, e kështu me radhë.

Rregullat gjuhësore dhe objektivat e sheriatit janë ato të cilat orientojnë në favorizimin e një çështjeje ndaj tjerave, gjë që shpie në ndryshimin e mendimeve nga këndvështrimi i muxhtehidëve dhe në ndryshimin e ligjeve praktike të cilat janë mbështetëse të saj.

Nëse për një çështje nuk ekziston teksti apo ixhmai, atëherë fusha e ixhtihadit bëhet në studimin për ligjësimin e asaj çështjeje prej argumenteve logjike, si f.v., kijasi, istihsani, parimi i interesit, ose tradita, ose istis’habi dhe argumenteve tjera për të cilat nuk janë pajtuar dijetarët për argumentimin e tyre.

Mund të përfundojmë me thënien se: Fusha e ixhtihadit është për dy çështje:

- **Për çështje për të cilat në esencë nuk ekziston tekst, ose**
- **për çështje për të cilat ka tekst jo të prerë.**

Ixhtihadi nuk bëhet në çështje të prera dhe për çështjet të cilat patjetër duhet pasur bindje, siç janë çështjet bazike të fesë, pasi që nuk ka çka të bëhet ixhtihadë në ato tekste.⁴⁹

Esenca e ixhtihadit ka të bëjë me ligjet praktike. Nëse ligji është i qartë nuk ka nevojë për ixhtihadë dhe është në kundërshtim me frymën e drejtësisë. Gjykatësit janë të obliguar t’i zbatojnë ligjet ashtu siç kanë ardhur, sepse interpretimi vjen prej Ligjvënësit⁵⁰ dhe nuk ka hapësirë të bëhet ixhtihadë në vendin e tekstit.

Tema e katërt: Dispozita e ixhtihadit

Kur te një person plotësohen kushtet e sheriatit dhe arrin aftësinë për të përpiluar ligje të sheriatit nga argumentet parciales, a e ka obligim të bëjë ixhtihadë, apo jo? Dijetarët kanë thënë: Kur një personi i ndodhë ndonjë rast, apo pyetet për një çështje, atëherë:

- **për të ixhtihadi është farz individual (farz ajn),**
- **ndonjëherë ixhtihadi është farz kolektiv (farz kifaje),**
- **ndonjëherë është i pëlqyer,**
- **ndonjëherë është haram.⁵¹**

1. **Farz personal (ajn)** është për një person të cilit i ndodhin ngjarjet, e nëse ai arrin të konkluzioni përfundimtar me ixhtihadin e tij, atëherë ai e ka për detyrë të veprojë me atë konkluzion dhe nuk i lejohet ta pasoj dikë tjetër prej muxhtehidëve për të drejtën e tij dhe për të drejtën e tjerëve, sepse dispozita (ligji) e muxhtehidit është dispozitë (ligj) e Allahut për çështjen në të cilën ka bërë ixhtihadë në bazë të mendimit të tij, andaj muxhtehidi duhet të veprojë me atë mendim, sepse ai ligj është ligj i Allahut të Lartmadhëruar.

Ixhtihadi është farz personal (ajn) edhe nëse ndodh që muxhtehidi pyetet për një çështje e cila veçse ka ndodhur, dhe ekziston frika se mund të kalojë në kuptim jo sheriatik, dhe nuk ka tjetër muxhtehidë që të bëjë ixhtihadë.

Kjo nga shkakun se mosmarrja me ixhtihadë nënkupton vonimin e sqarimit nga koha kur është paraqitur nevoja, e kjo ligjërisht është e ndaluar.

Karafiju thotë: Medhhebi i Malikut dhe pjesa dërrmuese e dijetarëve mendojnë se në atë rast ixhtihadi është obligim dhe nuk lejohet të pasohet.

2. **Por nëse nuk frikësohet se ekziston rreziku i humbjes së çështjes dhe ekzistojnë muxhtehidë tjerë, ajo çështje është obligim kolektiv (kifaje), dhe nëse ndonjëri prej muxhtehidëve bën ixhtihadë, atëherë të tjerët**

lirohen nga ai obligim. Nëse asnjëri nuk bën ixhtihadë, atëherë që të gjithë bëhen mëkatarë.

3. Ixhtihadi i pëlqyer: Është ixhtihadi për një çështje e cila nuk ka ndodhur, pa marrë parasysh a pyetet për atë çështje apo jo.

4. Ixhtihadi haram – është të bërit ixhtihadë në kundërshtim me tekstin e Kur'anit, ose sunetit, ose në kundërshtim me ixhmain.

Përpos këtyre rasteve, **ixhtihadi është i lejuar.**

Çështjet të cilat ndërlidhen me fushën e ixhtihadit

Është mirë t'i sqarojmë tri çështje të cilat ndërlidhen me dispozitën e ixhtihadit (ligjin e ixhtihadit) e ato janë:

- **ixhtihadi i pejgamberit s.a.v.s.;**
- **ixhtihadi i sehaveve në kohën e pejgamberit s.a.v.s.;**
- **epoka për të cilën mendohet se nuk ka muxhtehidë.**

Ixhtihadi i pejgamberit s.a.v.s.

Këtu kuptohet dispozita e ixhtihadit të pejgamberit s.a.v.s., dhe ajo se a lejohet të bëjë ixhtihadë apo jo?

Dijetarët janë dakorduar se, për pejgamberin s.a.v.s ka qenë e lejuar të bëjë ixhtihadë në çështje gjyqësore, në çështje të interesit të kësaj bote, në planifikimin e betejave, e të ngjashme.⁵²

Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme⁵³ dhe janë ndarë në shumë drejtime sa i përket ixhtihadit për ligje të shariatit dhe çështjeve të fesë në çështje për të cilat nuk ka tekst :

1. Shumica absolute e dijetarëve të usulit deklarojnë se: **Logjikisht, lejohet ixhtihadi i pejgamberit s.a.v.s. dhe praktikisht veçse ka ndodhur.**

2. Hanefijtë deklarojnë se, pejgamberi s.a.v.s. **ka qenë i urdhëruar që të bëjë ixhtihadë kur i ka ndodhë ndonjë rast**, por në rend të parë është dashur të presë shpalljen, përpos nëse është frikësuar se i ikë rasti, ai ka është dashur të jetë i bindur që të mos i ikë rasti kur ka pasur mundësi ta zgjidhë atë.

Ixhtihadi i tij ka qenë i specifikuar me kijasë dhe qëllimi i tij ka qenë i qartë dhe nuk ka pasur kundërshtim atëherë kur me ixhtihadin e tij ka marrë vendim, ai tekst është bërë argument i prerë, sepse pejgamberi s.a.v.s. nuk merr vendim të gabuar, siç do ta sqarojmë më vonë.

3. Shumica absolute e Esharijve dhe mutekeliminëve dhe shumica e muëtezilëve deklarojnë se, **nuk ka pasur të drejtë të bëjë ixhtihadë në ligjet e shariatit.**

Argumentet

Dijetarët të cilët kanë deklaruar se ixhtihadi i pejgamberit s.a.v.s. ka ndodhur, janë argumentuar me ndodhitë e betejave ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

عَفَا اللَّهُ عَنْكَ لِمَ أَذِنْتَ لَهُمْ

“Të ka falur Allahu, për atë që i ke lejuar ata.” (Et-Tevbe : 43)

Zoti i Lartmadhëruar e ka kritikuar pejgamberin s.a.v.s. pse i ka lejuar një grup prej hipokritëve që të mos merrnin pjesë në luftën e Tebukut. Po të kishte qenë “leja” nga shpallja, Allahu nuk do ta kishte kritikuar, por ka qenë në bazë të ixhtihadit.

Po ashtu janë argumentuar me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

لَوْلَا كِتَابٌ مِّنَ اللَّهِ سَبَقَ لَمَسَّكُمْ فِيمَا أَخَذْتُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ

“Po të mos ishte dispozita e hershme e caktuar prej Allahut (që preja të jetë e lejuar për umetin e Muhamedit), juve do t’ju kishte goditur një dënim i madh për atë që e morët.” (El-Enfal : 68)

Kjo është një kritikë tjetër, për shkak të pranimi të kompensimit për robërit e luftës së Bedrit, sepse nuk janë plotësuar kushtet e robërimit, e cila është mbizotërimi në tokë,⁵⁴ pra, dominimi dhe fuqia për t’i ekzekutuar robërit.

Katade Amër bin Mejmuni ka deklaruar se: “Dy çështje i ka vepruar pejgamberi s.a.v.s. dhe nuk ka qenë i urdhëruar:

- Lejimin e hipokritëve dhe pranimin e kompensimit për robërit, dhe Zoti i Lartmadhëruar e ka kritikuar butësisht.”

Prej ixhtihadit të pejgamberit s.a.v.s. është marrëveshja e pejgamberit s.a.v.s. me fisin Gatafan me një të tretën e prodhimtarisë së agronomisë së Medines.⁵⁵

Përderisa, sa i përket ixhtihadit në ligjet e sheriatit, shumica absolute e dijetarëve janë argumentuar se logjikisht është e lejuar, sepse nuk nënkupton diçka të pamundur nëse ndodhë.

Nëse presupozojmë se Ligjvënësi, i Cili është Allahu i Lartmadhëruar, e ka urdhëruar për ixhtihadë duke thënë: Ta kam bërë ty obligim të bësh ixhtihadë dhe të analogosh. Kjo nuk do të rezultonte diçka absurde, dhe ixhtihadi prej Muhamedit a.s. është i lejuar, dhe nuk ka koncept të lejimit të ixhtihadit përpos kësaj.

Përderisa sa i përket ndodhisë praktike, ka shembuj të ndryshëm, e disa prej tyre janë:

1. Kur’ani.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe analizoni o ju të zotët e mendjes.”**

Fjala **“analizoni”** ka të bëjë me analogjinë dhe ixhtihadin. Zoti i Lartmadhëruar i ka urdhëruar vizionarët, ndërsa peygamberi s.a.v.s. është vizionari më i madh i njerëzimit dhe më eksperti për analogjinë dhe kushtet e tij, dhe ai më i pari i urdhëruar për ixhtihadë. Kemi ajete tjera të shumta të cilat kërkojnë për analizim të çështjeve, ekspertizë të çështjeve dhe studim të çështjeve, ndërsa peygamberi s.a.v.s. është analizuesi më i miri i ajeteve të Kur’anit dhe eksperti më i madh.⁵⁶

Njësoj është edhe ajeti i këshillimit (konsultimit) ku Zoti i Lartmadhëruar thotë **“Dhe konsultohu për çdo çështje.”** tregon për çështjet të cilat gjykohen nëpërmjet ixhtihadit dhe jo çka gjykon nëpërmjet shpalljes.

2. Suneti.

Prej Muhamedit a.s. kanë rezultuar shumë çështje të ixhtihadit. Shembull: Kur Muhamedi a.s. ka thënë:

“Çka mendon sikur me ujë të shpërlajë gojën.”⁵⁷

“Çka mendon sikur babi yt të kishte borxh.”⁵⁸

Transmetohet se në Meke Muhamedi a.s. ka thënë:

“Mos i këputni bimët, mos i preni pemët.” Ibn Abasi i thotë: “Përpos IDHRIT (lloj trugu) për varrezat tona.” Pejgamberi s.a.v.s. thotë: **“Përpos IDHRIT.”⁵⁹**

Dihet se pejgamberi s.a.v.s. nuk e ka pritur shpalljen, dhe për atë rast nuk ka zbritur shpallje, ndërsa *përrjashtimi* është bërë nëpërmjet ixhtihadit.

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Kështu pra, mua më është dhënë Kur’ani dhe ngjashëm me të.”⁶⁰

Në haxhin lamtumirës ka thënë:

“LEV ISTEKBELTU MIN EMRI MA ISTEDBERT.”, që do të thotë: **“Po ta dija në fillim çka mësova më vonë, nuk do ta kisha vepruar këtë.”**

Tërheqja e kurbanit është prej veprimeve të haxhit.⁶⁰ Këtë e ka vepruar në bazë të ixhtihadit të tij dhe jo prej shpalljes, përndryshe Muhamedi a.s. nuk do të ishte penduar⁶¹ për atë që kishte vepruar, duke i dhënë përparësi të mos tërhiqej kurbanit dhe ngjarje të ngjashme të cilat Muhamedi a.s. nuk i ka vepruar prej shpalljes.⁶²

3. Argumenti logjik.

Të vepruarit me ixhtihadë është më i vështirë se të vepruarit me tekst sepse nevojitet lodhje e mendjes dhe shpenzim kohe, kështu që ka shpërblim më të madh, siç i ka thënë Muhamedi a.s. Aishes r.a.: **“Shpërblimi për ty në bazë të meritës tënde.”**⁶³

Po ashtu, Muhamedi a.s. ka thënë: **“Veprat më të vlefshme, janë më të rëndat.”**⁶⁴ që do të thotë, më të vështirat, dhe më të rrezikshmet.

Po nëse pejgamberi s.a.v.s. nuk do të bënte ixhtihadë, e dihet se disa dijetarë të umetit do të vepronin, atëherë pejgamberi s.a.v.s. do të duhej të dallohej me atë vlerë nga ajo pjesë e dijetarëve të umetit, sepse pejgamberi s.a.v.s. është më i vlefshmi i të gjithë njerëzimit.⁶⁵

Argumentet e mospranuesve të ixhtihadit të Muhamedit s.a.v.s.

Mospranuesit janë argumentuar me argumente të Kur'anit dhe të sunetit.

1.Argument prej Kur'anit

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: **“Dhe ai nuk flet nga vetja e tij, por është vetëm shpallje e cila i shpallet.”** En Nexhm3,4

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

قُلْ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أُبَدِّلَهُ مِنْ تَلَقَّاءِ نَفْسِي

“Thuaj: Mua nuk më takon që ta ndryshoj vetë, unë përcjell vetëm atë që më shpallet.” (Junus : 15)

Këto dy ajete tregojnë se, ligjet të cilat burojnë nga pejgamberi s.a.v.s. janë prej shpalljes dhe nga ixhtihadi, sepse disa prej çështjeve të cilat i ka thënë do të ishin prej tij, atëherë thënia e Zotit të Lartmadhëruar për të do të ishte gënjeshtër, ndërsa është absurditet që lajmërimi i tij të jetë gënjeshtër.

Replikë nga dy aspekte:

Ajeti në fjalë për qëllim e ka Kur'anin, dhe padyshim se Kur'ani është prej Allahut dhe nuk është prej pejgamberit s.a.v.s. Këtë e sqarojnë shkaqet e zbritjes së ajeteve, se pabesimtarët pretendonin se Muhamedi a.s. vet e shkruan Kur'anin dhe thotë se Kur'ani është prej Allahut dhe si kundërpërgjigje ndaj tyre kanë zbritur ajetet, dhe ajetet nuk janë në kundërshtim me atë se përpos Kur'anit, ekzistojnë edhe çështje tjera që arrihen prej ixhtihadit të pejgamberit s.a.v.s. Ajeti i dytë e demanton atë koncept sepse pejgamberi s.a.v.s. asgjë nuk ndryshon prej vetes së tij, por e pason atë çka i shpallet prej Zotit të Lartmadhëruar.

Edhe nëse e pranojnë se ajeti është i përgjithshëm për Kur'anin dhe çështjet tjera, ne nuk e pranojmë se çka buron prej ixhtihadit nuk është e llojit të shpalljes, por është shpallje prej Allahut, sepse shpallje është ajo çka është kërkuar të bëjë ixhtihadë dhe të veprojë me të.⁶⁶

Përfundim – Nga aspekti i jashtëm ky argument të cilin e përmendin mospranuesit është siguri i ligjësimin të sheriatit nga kritikë, dhe e vërteta është se ato janë vetëm fjalë për siguri dhe përkujdesje dhe nxjerrjen e teksteve të Kur'anit jashtë kontekstit të cilin e kërkon shpjegimi.⁶⁷

2.Argumenti logjik

Mund ta shikojmë në shumë aspekte,⁶⁸ por më të rëndësishmet janë:

E para: Ixhtihadi tregon të dyshimtën dhe kur ekziston e sigurta nuk lejohet të veprohet me të dyshimtën, ndërsa pejgamberi s.a.v.s. ka pasur mundësi për të sigurtën sepse ka pasur mundësi për ta pyetur Zotin e Tij, ka mundur të pres për t'i zbritur shpallja për çdo gjë që ka pasur nevojë për ligjësim të ligjeve, ndërsa Zoti i Lartmadhëruar iu kishte përgjigjur pozitivisht, kështu që pejgamberi s.a.v.s. nuk do të kishte bërë ixhtihadë.

E dyta: Po t'i ishte lejuar atij që të bënte ixhtihadë për ligjësim të ligjeve të sheriatit, nuk do të kishte ndodhur vonimi i zgjidhjes së ngatërresave dhe gjykimeve, deri sa të zbriste shpallja, sepse zakonisht duhet të bëhet gjykimi sa më shpejt, dhe ai ka pasur mundësi që të bëj ixhtihadë, mirëpo ka pritur (deri sa të zbret shpallja) në rastin e “DHIHARIT” dhe të “LIANIT”. Ndërsa kur është zbritur për zekatin “Hamijr” është përgjigjur: **“Nuk më ka zbritur përpos këtij ajeti gjithëpërfshirës.”**

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ

وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ

“E kush e punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe sa grimca, atë do ta gjejë.” (Ez-Zilzal : 7,8)

Replikë e rastit të parë: Është e lejuar që Muhamedi a.s. të mos e pyes Zotin e Lartmadhëruar pa i dhënë leje atij, ose ai nuk ka qenë çështje e tij deri sa të zbret shpallja, dhe deri atëherë ai është dashur të bëj ixhtihadë.

Replikë e rastit të dytë: Është e mundur se e ka pritur zbritjen e shpalljes, ashtu që t'i humb shpresat se do t'i zbret shpallja (për atë çështje) e cila është kusht që të mos bën ixhtihadë përballë tekstit, derisa të kaloj një periudhë kohore, derisa ta kuptoj se Zoti i Lartmadhëruar nuk do t'i zbret shpallje, ose edhe ka pritur shpallje sepse nuk ka hasur deri atëherë ndonjë bazë me të cilën do të bënte analogji dhe do të bënte ixhtihadë, ose edhe ka pritur deri në momentin kur i ka shpenzuar të gjitha mundësitë në ixhtihadë.

Dhe, përderisa argumentet e mospranuesve përballë argumenteve tjera dhe përcaktimit nuk ishin fitimtarë, atëherë unë e favorizoj drejtimin e shumicës absolute të cilët deklarojnë se: **Lejohet ixhtihadi i pejgamberit s.a.v.s. dhe kjo veçse ka ndodhur dhe ky është opinionin i saktë.**

A është e mundur që pejgamberi s.a.v.s. të gabojë në ixhtihadë?

Dijetarët janë pajtuar se, pejgamberi s.a.v.s. nuk miraton një çështje gabim me ixhtihadin e tij, ashtu që ai gabim të mos kalojë te umeti i tij dhe ai gabim të veprohet në umetin e tij.

Dijetarët nuk janë pajtuar në atë se a lejohet që pejgamberi s.a.v.s. të gabojë kur bën ixhtihadë.⁶⁹

Një pjesë e dijetarëve, e prej tyre Raziju dhe Bejdaviju deklarojnë se: Është e pamundur që kur Muhamedi s.a.v.s. bën ixhtihadë, të gabojë. Gjithmonë ai është i pagabueshëm në ixhtihadin e tij.

Ibn Sebkiju deklaron: E vërteta është se pejgmberi s.a.v.s nuk mund të gabojë për shkak të pejgamberisë, i cili titull e bën që të jetë i pagabueshëm në ixhtihadin e tij.⁷⁰

Shumica e dijetarëve deklarojnë se lejohet që pejgamberi s.a.v.s. të gabojë në ixhtihadin e tij, në çështje të cilat nuk kanë të bëjnë me kumtimin e shpalljes, me kusht që të mos i aprovohet ai gabim.

Argumentet

Argumentet e të parëve

E para: Po të lejohej gabimi në ixhtihadin e tij, atëherë ne do ta kishim obligim ta pasonim atë, sepse ne jemi të urdhëruar që ta pasojmë atë, në bazë të thënies së Zotit të Lartmadhëruar:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ

“Thuaj: Nëse dëshironi ta doni Allahun, më pasoni mua, se do t’ju dojë Allahu.” (Ali Imranë : 31) e kjo do të na shpinte në pavlefshmëri, e Zoti i Lartmadhëruar nuk na urdhëron për gjëra të pavlefshme, por urdhëron në drejtësi dhe në bamirësi.

Replikë: Çështja se ai mund të gabojë kur bën ixhtihadë nuk nënkupton se patjetër duhet të pasohet, sepse pejgamberi s.a.v.s. nuk miraton çështje gabim. Çështja se duhet të pasohet, është të pasohet ixhtihadi i drejtë (i qëlluar) në këndvështrimin e dijetarit, edhe nëse është në kundërshtim me realitetin.

Dhe kur ta pranojmë argumentin, do të ishte i kundërshtuar me obligimin e pasimit të njeriut të rëndomtë në muxhtehidin për atë që e shpie edhe pse ekziston mundësia se ai ixhtihadë të jetë gabim.

E dyta: Po të lejohej gabimi në ixhtihadë, atëherë umeti do të ishte në rangun e tij, dhe umeti (ixhmai) është i garantuar në pagabueshmëri, edhe pse ixhtihadi i pejgamberit s.a.v.s. ka përparësi ndaj ixhtihadit të ixhmait

sepse pagabueshmëria e ixhmait është si rezultat i thënies së pejgamberit s.a.v.s.

Replikë – Specifikimi i unifikimit të umetit (ixhmait) nuk e degradon përsosmërinë e pejgamberit s.a.v.s. sepse pejgamberi s.a.v.s. është i specifikuar me gradë më të lartë.

Hanefijtë e replikojnë edhe atë se, kur ixhtihadi i tij arrin rezultatin përfundimtar, atëherë ixhmai nuk favorizohet nga teksti.⁷¹

Drejtimi i dytë argumentohet me atë se: po të mos lejohej gabimi në ixhtihadin e tij, atëherë nuk do të ndodhte, por gabimi veçse ka ndodhur, për këtë arsye lejohet ndodhia e gabueshmërisë së tij me argumentet si në vijim:⁷²

E para: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: “Allahu të ka falur, për atë se i ke lejuar ata.” (Et-Tevbe : 43).

Siç e sqaruam më herët, Zoti i Lartmadhëruar e ka kritikuar pejgamberin s.a.v.s. për atë se i ka lejuar disa hipokritë që të mos merrnin pjesë në betejën e Tebukut. Gabimi i tij kuptohet se ishte në *lejimin e tyre*, e argumentim për këtë është kritika ndaj tij dhe mënyra se si i është tërhequr vërejtja.

E dyta: Sa i përket rregullit të lirimit të robërve të Bedrit, Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

مَا كَانَ لِنَبِيٍّ أَنْ يَكُونَ لَهُ أَسْرَى حَتَّى يُثْخِنَ فِي الْأَرْضِ

“Për asnjë pejgamber nuk qe me vend të ketë robër derisa ta ketë dërmuar me luftë (armikun) në tokë.” (El-Enfal : 67)

Kjo kritikë ka qenë për Muhamedin a.s. i cili mori kompensim për robërit e luftës, ashtu siç e dha propozimin Ebu Bekri, dhe nuk e pranoi

mendimin e Umerit i cili propozoi ekzekutimin e tyre, kështu që është paraqitur gabim në të vepruarit sipas mendimit të parë, e argument është ky ajet i cili ia tërheq vërejtjen pejgamberit s.a.v.s.

E treta: Është kritikuar pejgamberi s.a.v.s. me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَإِذْ تَقُولُ لِلَّذِي أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِ وَأَنْعَمْتَ عَلَيْهِ أَمْسِكْ عَلَيْكَ زَوْجَكَ

“(Përkujto) Kur i the atij që All-llahu e kishte shpërblyer (me besim) e edhe ti i pate bërë mirë: Mbaje bashkëshorten tënde dhe kij frikë nga All-llahu!” (El-Ehzab : 37)

Kritika për mbajtjen sekret martesën me Zejnebe bint Xhahshin, gruan e robit Zejd, pas shkurorëzimit të saj, dhe pas kalimit të idetit të saj, për të shpallur të pavlefshme prej Zotit të Lartmadhëruar ligjin e adoptimit, ligj i cili ekzistonte në kohën e injorancës.

Këto që i thamë më parë i vërteton edhe hadithi i çiftëzimit të hurmave: **“Një herë, pejgamberi s.a.v.s. kalon pranë një shoqërie e cila bënte çiftëzimin e hurmave, ndërsa pejgamberi s.a.v.s. u thotë: Po nëse nuk veproni ashtu do të ishte më mirë. Ato hurma nuk sollën fryte.”⁷³**

Pastaj pas një kohe kalon pranë tyre dhe i pyet: Çka u bë me hurmat?

Ata iu përgjigjën: Na ke thënë kështu, dhe kështu!?

Atëherë pejgamberi s.a.v.s. u tha: Ju jeni më të ditur për çështjen e jetës suaj, ose, ju e dini më së miri çka është më e mira dhe më e dobishmja për jetën e juaj.”⁷⁴

Sa i përket çiftëzimit të hurmave, në një transmetim tjetër pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Nëse është e dobishme për ju, veprojeni atë, sepse unë jap vetëm një mendim personal timin, dhe mos ma zini për të madhe**

për atë mendim personal timin, mirëpo, kur unë ju tregoj juve diçka nga Allahu, pranojeni, sepse unë nuk gënjej për Allahun.”⁷⁵

Në një transmetim tjetër ka thënë: “Pa dyshim se unë jam vetëm një njeri, dhe nëse u them diçka për fenë tuaj, pranojeni, por nëse them diçka nga ideja ime, atëherë unë jam vetëm njeri.”⁷⁶ në tekst tjetër “Atë çka u lajmëroj juve se është prej Allahut, ajo çështje është çështje për të cilën nuk ka dyshim.”⁷⁷

Në transmetim tjetër “Pa kurrfarë dyshimi se unë jam njeri sikurse ju, atë çka e flas prej Allahut është e drejtë, përderisa atë që e them nga vetja ime, unë jam vetëm njeri, e qëllor por edhe mund të gaboj.”⁷⁸

Është raportuar se Ibn Abasi ka thënë: “*Çdonjërit mund t’i pranohet ose mund të mos i pranohet mendimi i tij përpos pejgamberit s.a.v.s.,*⁷⁹ të cilit çdoherë i pranohet mendimi i tij.” që do të thotë, i pranohet mendimi i tij (Muhamedit a.s.) në çështje të cilat i shpallen dhe jo në çështje të ixhtihadit (në çështje të ixhtihadit mund edhe të mos i pranohet mendimi). Prej rasteve të tilla është: Vendimi i pejgamberit s.a.v.s. që të arrij marrëveshje paqeje me fisin Gatafan për një të tretën e fryteve të pemëve të Medinës.

Ixhtihadi i sehabeve në kohën e pejgamberit s.a.v.s.

Dijetarët janë pajtuar se, lejohet ixhtihadi i sehabeve pas pejgamberit a.s., por nuk janë pajtuar në lejimin e ixhtihadit të tyre në kohën e pejgamberit s.a.v.s. dhe atë në shumë drejtime:⁸⁰

- **Disa dijetarë të usulit thonë se, logjikisht kjo nuk lejohet,**
- **disa të tjerë thonë se, logjikisht kjo nuk lejohet dhe se nuk ka ndodhur.**
- **Shumica absolute e dijetarëve thonë se lejohet ixhtihadi në kohën e pejgamberit s.a.v.s. edhe në prezencën e tij, edhe në mosprezencën e tij dhe veçse ka ndodhur.**
- **Disa e bëjnë dallimin dhe thonë:**
 - lejohet ixhtihadi i atij i cili nuk është në prezencën e tij, ndërsa
 - nuk lejohet ixhtihadi në prezencën e tij.

Argumentet

Ata të cilët thonë se nuk lejohet logjikisht, janë argumentuar me argumentet si në vijim.

E para: Pa kurrfarë dyshimi se ixhtihadi i sehabiut nënkupton edhe atë se, ata i nënshtrohen gabimit, përderisa ixhtihadi i tyre në kohën e pejgamberit s.a.v.s. është ixhtihadë përballë mundësisë së rrugës së sigurt dhe mosgabimit, dhe diturisë bindëse dhe të sigurt, andaj ky ixhtihadë (pas pejgamberit s.a.v.s.) logjikisht është i pakuptueshëm.

E dyta: Sehabet ktheheshin te pejgamberi s.a.v.s. për të mësuar (kuptuar) dispozitën e ndonjë ngjarjeje të re. Po të ishte i lejuar ixhtihadi i tyre, nuk do të kishte qenë nevoja të ktheheshin tek ai.

Replika ndaj argumentit të parë është se, sehabet nuk kanë mundur të shkonin te pejgamberi s.a.v.s. për çdo rast, pasi ndonjëherë kanë qenë larg, e ndonjëherë edhe janë kthyer te ai e nuk e kanë gjetur dispozitën e asaj ndodhie të ligjësuar nga shpallja, atëherë çështja mbetej e hapur për ixhtihadë.

Replika e argumentit të dytë: Lejimi i ixhtihadit për sehabet nuk nënkupton se ata nuk duhet të kthehen te pejgamberi s.a.v.s. sepse ata kthehen te ai atëherë kur nuk arrijnë deri te dispozita për ngjarjen nëpërmjet ixhtihadit, ose për shkak të lehtësimit të kuptimit të dispozitës nëpërmjet rrugës së pejgamberit s.a.v.s.

Janë argumentuar edhe me atë se, nuk ka ndodhur ixhtihadë prej tyre, sepse po të kishte ndodhur do të na ishte raportuar, por, përderisa nuk na është raportuar tregon se nuk ka ndodhur.

Replikë e këtij argumentimi në dy aspekte:

E para: Mosraportimi mund të jetë për shkak se ka ndodhur shumë rrallë ixhtihadë prej tyre.

E dyta: Janë raportuar shumë raste të ixhtihadit prej disa prej sehabeve, si f.v., Ebi Bekrit, Sead bin Muadhit, Amr bin el-Asit, Muadh bin Xhebelit, Ebi Musa el-Eshariut, e të tjerë, të cilët do t'i sqarojmë më vonë dhe nuk thuhet se këto janë raportime të vetmuara, siç e tregon Gazaliu,⁸¹ dhe nuk lejohet që të bazohet në to sepse kjo çështje është prej çështjeve të pasigurta dhe dihet se informatat e vetmuara tregojnë për argument të pasigurt, por prapë se prapë mjaftojnë të llogariten si argument.

Argumentet e shumicës absolute

Shumica absolute e dijetarëve argumentohen se, logjikisht kjo lejohet, sepse nuk është absurditet po të presupozonim se ka ndodhur ixhtihadi prej sehabëve në kohën e pejgamberit s.a.v.s. Kështu që është e lejuar dhe është rrugë e vërtetimit se logjikisht është i lejuar dhe janë argumentuar se ka ndodhur në raste të shumta, e prej tyre:

1. Hadithi i mirënjohur i Muadhit, kur pejgamberi s.a.v.s. e ka dërguar për gjykatës në Jemen, atë së bashku me Musa el-Esharijun dhe i ka pyetur:

“-Me çka do të gjykoni?

Ata përgjigjen: - Me librin e Allahut.

-Po nëse nuk e gjeni zgjidhjen aty? – i pyet i dërguari s.a.v.s..

-Me sunetin e të dërguarit të Allahut – i përgjigjen.

-Po nëse nuk e gjeni zgjidhjen aty?

-Do të analogojmë me çështje të ngjashme, nëse është shumë e përafërt do të veprojmë me të.

-Keni thënë të drejtën dhe ia keni qëlluar – u thotë pejgamberi s.a.v.s.”

Ky është miratim se është i lejuar ixhtihadi i sehabëve kur pejgamberi s.a.v.s. nuk është në mesin e tyre.

2. Në betejën e Hunejnit pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Kush vret një luftëtar të anës kundërshtare ai meriton armën e tij.”** Ebu Katade e vret një luftëtar të palës kundërshtare, për këtë edhe e meritonte armatimin e të vrarit. Disa prej sehabëve e kanë parë këtë, mirëpo dikush tjetër e kishte marrë armatimin e të vrarit dhe shkon te pejgamberi s.a.v.s. për t’i treguar dhe për ta qetësuar Kataden, se ai e kishte marrë armatimin, duke i thënë pejgamberit s.a.v.s se armatimi i atij të vrari ishte tek ai dhe se duhej ta pranonte se i përkiste atij.

Ebu Bekri i thotë atij i cili e kishte marrë armën e të vrarit: -Jo, për Zotin.⁸² O i dërguar i Allahut lejoje që ta marrë Esedi prej Esvedit (Ebu Katade).

Pejgamberi s.a.v.s thotë: - Ashtu qoftë, të vërtetën e ka thënë (Ebu Bekri).

Ky është miratim i pejgamberit s.a.v.s. për ixhtihadin e Ebu Bekri Sidikit në prezencën e tij.

Vetëm se (analisti i këtij hadithi) këtë ngjarje e ka replikuar si në vijim:

Ixhtihadi i Ebu Bekrit për këtë rast nuk nënkupton të drejtën e zgjedhjes së mendimit të tij në mënyrë absolute, nga shkakku se Ebu Bekri r.a. e ka ditur se është në prezencë të Muhamedit a.s., që nëse nuk e thotë të vërtetën, përmirësohet.

Kjo do të thotë se ky rast nuk është rast i llojit të ixhtihadit sepse nuk ka pasur mundësi të gaboj dhe nuk ka pasur mundësi të zgjedh në mes të mendimit të tij dhe ixhtihadit dhe vendimit të pejgamberit s.a.v.s.⁸³

Unë nuk e përkrahi mendimin e analistit sepse tema e ixhtihadit në këtë rast nuk ka të bëjë me bazën e vërtetimit të së drejtës së pasurisë së luftëtarit, por tema është kompensimi i pasurisë së luftës, ndërsa Ebu Bekri e ka paraparë se cili është më meritor se tjetri dhe pejgamberi s.a.v.s. e miratoi ixhtihadin e tij.

3. Është vërtetuar se pejgamberi s.a.v.s. është pajtuar me gjykimin e Sead bin Muadhit për fisin Beni Kurejdha, pastaj kur ka gjykuar për ekzekutimin e burrave të tyre dhe robërimin e grave të tyre, pejgamberi s.a.v.s. pasi e ka miratuar propozimin e mendimeve të tyre ka thënë: **“Unë kam gjykuar për ta, me gjykimin e Allahut, me të cilin ka gjykuar mbi shtatë qiej.”⁸⁴**

4. Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë Amr bin Asit: **“Gjyko për këto çështje.**

Ai i përgjigjet – Po si të bëj ixhtihadë kur ti je prezent?

Pejgamberi s.a.v.s. i thotë: - Po! Nëse ia qëllon i ke dy shpërblime, nëse nuk ia qëllon, e ke vetëm një shpërblim.”⁸⁵

Ukbete bin Amirit dhe një sehabiu tjetër u thotë që të gjykojnë për një çështje të ngatërresës së dy individëve që ishin në konflikt në mes vete, pejgamberi s.a.v.s. u thotë: **Bëni ixhtihadë, nëse ia qëlloni i keni nga dhjetë shpërblime, ndërsa nëse nuk ia qëlloni e keni nga një shpërblim.**⁸⁶

Pejgamberi s.a.v.s. ia ka miratuar Amr bin Asit kur ai ua ka falë namazin shokëve të tij, pasi që për shkak të papastërtisë nuk kishte marrë gusël, por tejemum, duke u argumentuar me thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ

“Dhe mos e mbytni veten tuaj.” (En-Nisa : 29)⁸⁸

Pejgamberi s.a.v.s. ua ka miratuar dy njerëzve tejemumin, pastaj njërit i ka thënë kur të gjen ujë të merr abdes dhe ta përsëris namazin, dhe tjetrit i ka thënë të mos e përsëris namazin.

Këto raste, dhe raste tjera të ngjashme, dëshmojnë për lejimin e ixhtihadit të sehabeve dhe se ixhtihadi i sehabëve ka ndodhur edhe në prezencën e pejgamberit s.a.v.s. edhe në mosprezencën e tij.

Përderisa, sa i përket atyre të cilët bëjnë dallimin në mes të prezencës dhe mosprezencës, bazohen në argumentin e miratimit të rastit të Muadh bin Xhebelit, me ixhtihadin e tij kur pejgamberi s.a.v.s. e ka dërguar në Jemen, dhe disa raste tjera të cilat i përmendëm, mirëpo ixhtihadi në prezencën e pejgamberit s.a.v.s. nuk lejohet sepse pejgamberi s.a.v.s. është burim i ligjeve të sheriatit. Këtë mendim e favorizon Shevkaniju.⁸⁹

Përfundim – Unë nuk e shoh të arsyeshme që ta zgjasë më shumë këtë temë, sepse siç e thotë Fahu Razi, mospajtimi i tyre nuk prodhon ndonjë efekt juridik në fikh, sepse ixhtihadin e sehabijut nëse e miraton pejgamberi s.a.v.s. është argument ligjor i sunetit miratues dhe jo prej ixhtihadit të sehabes, por nëse nuk arrin te Muhamedi a.s. atëherë bën pjesë në temën e mospajtimit në mes të sehaveve, të cilën e kemi sqaruar.

Ideja për epokën pa muxhtehidë

Studimi për këtë çështje ndërlidhet me dispozitën e ixhtihadit sepse deklarimi për obligueshmërinë e ixhtihadit nënkupton që asnjë epokë të mos jetë pa muxhtehidë.

Sujturi në librin e tij **“Err-Rred men ehlede ilel-erd”** të cilën e kam përmendur edhe më herët. Kapitullin e parë ia ka kushtuar sqarimit të obligueshmërisë së ixhtihadit të çdo epoke. Ndërsa kapitullin e dytë ia ka kushtuar çështjes se, logjikisht dhe ligjërisht nuk lejohet të kalojë ndonjë epokë pa muxhtehidë, mirëpo unë nuk kam hasur se dijetarët janë pajtuar me këtë mendim, por kam parë se kanë dhënë mendime të ndryshme.⁹⁰

Një pjesë e dijetarëve Hanbelijë, profesori Isfiraniju dhe Zibidiju dijetarë Shafij, deklarojnë se: Nuk lejohet që një epokë prej epokave të jetë pa muxhtehidë përderisa në mes njerëzve ekziston prej asaj çka u është zbritur dhe u është sqaruar çka është ligjësuar prej Zotit të tyre.

Në rend të parë, mendimin e tyre e argumentojnë me thënien e pejgamberit s.a.v.s.: ***“Gjithmonë do të jetë një grup i umetit tim i cili do ta dëshmon dhe do ta pasqyroj të vërtetën deri në ditën e Kijametit.”***⁹¹

Përmbajtja e këtij lajmërimi mbetet e mangët (e parealizueshme) nëse mbetet ndonjë epokë pa dijetarë të cilët dëshmojnë dhe ua pasqyrojnë të tjerëve të vërtetën.

E dyta, ixhtihadi është farz kolektiv, sepse ngjarjet janë të pafundme dhe të panumërta, nëse një epokë mbetet pa muxhtehidë, atëherë janë dakorduar dijetarët për padrejtësi dhe në gabim, edhe pse umeti është i siguar të mos gabojë.

Shumica e dijetarëve, e prej tyre, Raziu, Gazaliu dhe Kefali, dhe pjesa tjetër e medhhebeve deklarojnë se: Lejohet të mbetet ndonjë epokë pa muxhtehidë dhe argumentohen me hadithin: “Vërtetë Allahu nuk e ngritë diturinë me ngritje (të diturisë) nga robërit, por e ngritë diturinë duke bërë që të vdesin dijetarët, derisa nuk mbetet dijetar dhe njerëzit marrin si udhëheqës të paditurit të cilët japin përgjigje pa pasur dijeni, kështu humbin njerëzit dhe humb edhe ai vet.”⁹²

Pejgamberi s.a.v.s. ka lajmëruar se do të vjen një kohë ku të gjithë do të jenë të paditur dhe nuk do të ketë muxhtehidë në mesin e tyre.

Mendimi se, nuk mund të ketë epokë pa muxhtehidë, përgënjeshtrohet këtë hadithë (lajm), përderisa përgënjeshtrimi mbi lajmërimin e pejgamberit s.a.v.s. është absurd.

E vërteta është se hadithi nuk tregon se lejohet të mbetet ndonjë epokë pa muxhtehidë sepse hadithi tregon për fundin e botës, dhe një shenjë prej shenjave të ditës së kijametit sepse poqëse nuk ka fukaha, nuk mund të plotësohen të gjitha farzet, dhe kur të paralizohen të gjitha farzet, atëherë ndodh tragjedia në tokë, siç thuhet në transmetim: **“Nuk do të bëhet dita e kijametit, pos kur të ketë vetëm njerëz të këqij.”**⁹³

Shihet qartë se, këta nuk kanë argumente, vetëm se tregohen ekstrem në përcaktimin e kategorizimit të ixhtihadit, dhe përkufizimi vetëm në dijetarët e mëhershëm dhe të përmbajturit e vazhdimit të rrugës së tyre, edhe pse mjetet e ixhtihadit plotësohen edhe te gjeneratat pas tyre, bile edhe më shumë se ato sepse kur Zoti i Lartmadhëruar vlerëson diturinë dhe perceptimin nuk e përkufizon në një kohë apo në ndonjë kohë tjetër, ose qëllimi është për muxhtehidët absolutisht të pavarur të cilët i kanë vendosur bazat e fikhut dhe nuk ka dyshim se kjo ka ndodhur, dhe askush nuk mund të shtoj diçka, përderisa llojet tjera të muxhtehidëve, nuk mbetet ndonjë epokë pa to.

Ebu Neimi në *“Hulijeti”* e ka regjistruar hadithin nga Ali bin Ebi Talibi r.a. se ka thënë: ***“Nuk do të mbetet toka, pa argumentuar për Allahun, që të mos asimilohen argumentet dhe sqarimet për Allahun, ato do të jenë në numër të vogël, por do të jenë madhështore në vlerë tek Allahu”***. Për këtë hadithë Sujutiu⁹⁴ ka thënë: “Ky hadithë është mevkuf, ndërsa dispozitën e ka “merfuë” sepse këso përmbajtje nuk thuhet nga vetvetja dhe hadithi ka fakte të hadithit “mevkuf” por edhe të hadithit “merfuë” sepse thënie të tilla nuk thuhet nga vetvetja. Ka elemente të hadithit “merfuë” dhe “mevkufë”.”

Pastaj kemi hadithin e pejgamberit s.a.v.s.: ***“Shpejtoni para se të ju vjen nata sepse nëse nuk shpejtoni para se të ju vjen nata, nuk ka kush t’i mbroj muslimanët sepse atyre veçse u ka ardhur nata dhe kush flet, flet në përputhshmëri të asaj që është mbyllur.”***⁹⁵ Dijetarët këtë thënie e kanë përcjellë me vëmendje, pra thënien e njohur nga Aliu r.a. Zoti e fisionëroftë, saqë Sujutiu ka thënë: *“(Kjo thënie) Sikur të ishte ixhmaë.”* ashtu siç e thamë se është thënie e llojit të hadithit apo gjurmimit të hadithit.

Në librin *“El Bahr”* Zerkashiju i eliminon argumentet e atyre të cilët deklarojnë se mund të ketë epokë pa muxhtehidë, dhe thotë: ***“Thënia e tyre se mund të ketë epokë pa muxhtehidë është çështje që të habitë sepse si është e mundur ta kenë thënë këtë duke e ditur se kanë qenë bashkëkohës të Kafalit, Raziut, Rafijut, të cilët janë dijetarë të shkencave të ixhtihadit mjaftueshëm dhe një grupi dijetarësh prej tyre të përsosur në këtë lëmi dhe ka prej tyre të cilët janë të profilizuar në histori dhe në paraqitjen e biografisë dhe specifikat e dijetarëve islam të secilës epokë dhe nuk ka mbetur asgjë mangë në këtë drejtim.”***

Nëse e mendojmë këtë në këtë koncept ose në konceptin se Zoti i Lartmadhëruar i ka ngritur ata të cilët i ka dalluar nga umeti deri në këtë kohë, në të kuptuarin perfekt, mendjehollësinë tepër të madhe dhe aftësi për shkencë, këto pretendime janë të pazakonta dhe të pavlefshme, bile janë injorancë.

Nëse mendojnë se para tyre ka pasur lehtësi për të mësuar dhe tash ka vështirësi, këto janë pretendime të pabazuara, sepse nuk mund të fshihet

fakti se ixhtihadi i dijetarëve të mëvonshëm ka pasur lehtësime të cilat nuk i kanë pasur dijetarët e mëhershëm sepse janë botuar aq shumë libra të komentimit të Kur'anit fisnik sa që nuk mund të numërohen. Është bërë koleksionimi i haditheve të pastra. Dijetarët kanë shkruar për tefsirin, për regjistrimin e haditheve, për saktësimin e tyre, për krahasimin e tyre e cila është ndihmesë shtesë për kërkesat e muxhtehidit. Dijetarët e hadithit para këtyre mohuesve për një hadithë të vetëm kanë udhëtuar nga një kënd në këndin tjetër.⁹⁶

Për dijetarët e mëvonshëm ixhtihadi është më i lehtë dhe më komod se sa ixhtihadi i dijetarëve të mëhershëm. Ai i cili ka logjikë të shëndoshë dhe kuptim të drejtë këtë nuk e mohan.⁹⁷

Për këtë temë e zgjata pak si shumë sepse për të nevojitet analizë më e thellë dhe sqarim më i thjeshtë dhe argumentim më i fuqishëm ndaj atyre të cilët pretendojnë se dera e ixhtihadit është e mbyllur, dhe të cilët i detyrojnë njerëzit në pasim (taklidë). Ata këtë e thonë prej vetes së tyre sepse nuk kanë besim në veten e tyre, në nivelin e diturisë të cilën e kanë arritur, e cila u mundëson secilit prej tyre të merren me ixhtihadë dhe thuaja se ata e kanë ndier veten e tyre se e kanë arritur gradën e ixhtihadit, siç u kuptua prej debatit të tyre, argumentimit të tyre dhe pavarësimit të tyre për të dhënë ide, mendime, për të kuptuar drejtë dhe për të bërë krahasime dhe favorizim të mendimeve vetëm se ato nuk shkojnë në atë drejtim të paraqitjes së tyre në shoqëri idenë se dera e ixhtihadit është e mbyllur, por e vendosin veten e tyre në një medhheb prej medhhebeve e pastaj bëjnë ixhtihadë sikurse ka vepruar vet Gazaliu ku në njërën anë thotë se është epoka në të cilën nuk ka muxhtehidë, ndërsa në anën tjetër thotë se nuk është pasues i medhhebit Shafiij, por mendimi i tij përputhet me medhhebin Shafiij dhe në librat e tij⁹⁸ shohim ixhtihade të shumta.

Kush i përcjell me vëmendje librat e dijetarëve të mëvonshëm mund të gjej fakte të gjalla të ixhtihadit absolut, si p.sh., në librat e:

- Ibni Kajimit,
- el-Iz Abdus-Selamit,
- Ibni Dekikit,
- Ibni Sejid en-Nasi,
- Zejnud-dijn el Irakiu,
- Ibn Haxher el-Askelaniju, dhe

- Sujutiu, e të tjerë të cilët kanë arritur nivelin e ixhtihadit, dhe prapë se prapë thonë se *është koha në të cilën nuk ka muxhtehidë*.⁹⁹

Tema e pestë: Ixhtihadi i pjesshëm

Ixhtihadi i pjesshëm nënkupton: **Që dijetari të ketë mundësi të përfitoj ligjin për një çështje dhe nuk ka mundësi në një çështje tjetër, ose përfiton ligjin për një lëmi, ndërsa nuk ka mundësi për ndonjë lëmi tjetër.**

Muxhtehidi i pjesshëm është njohës i përfitimit të disa ligjeve,¹⁰⁰ e kjo pasi ai t'i ketë plotësuar kushtet e ixhtihadit. Nëse në këtë aspekt është i aftë, atëherë ai muxhtehidë a duhet të bëj ixhtihadë vetëm për atë çështje, apo patjetër duhet të jetë muxhtehidë absolut?

Dijetarët kanë dhënë mendime ndryshme rreth çështjes së ixhtihadit vetëm në disa çështje, si p.sh., ixhtihadi vetëm për çështje të trashëgimisë...

Shumica e dijetarëve mendojnë se: Lejohet ixhtihadi i pjesshëm, pra duke pasur njohuri vetëm rreth një çështjeje dhe çka duhet patjetër në atë çështje edhe pse nuk e di ndërlihdjen në çështjet tjera të fikhut.

Disa kanë thënë: Nuk lejohet, sepse çështjet e një lloji të fikhut ndoshta e kanë bazën nga një lloj tjetër e jo prej saj.¹⁰¹

Shumica e dijetarëve argumentohen si në vijim:

1. Po të mos ishte ixhtihadi i pjesshëm do të nënkuptohej që muxhtehidi do të duhej t'i dinte të gjitha çështjet, me ligjësim dhe me argumentim, mirëpo kjo nuk nënkuptohet kështu, sepse nuk është shart për mufti që të jetë i ditur për të gjitha ligjet dhe t'i perceptoj të gjitha çështjet. Kjo për njeriun është e pamundur. Imam Maliku është imam me Ixhmaë dhe prapëseprapë kur është pyetur për dyzetë çështje, në tridhjetë e gjashtë prej

tyre ka thënë *nuk e di*. Në sa e sa çështje është ndalur Shafiiju, e po ashtu edhe sehabet.

2. Nëse dijetari i zbulon elementet e disa çështjeve, atëherë edhe elementet e çështjeve tjera janë njësoj, mirëpo, natyrshmëri e tij është se nuk i di elementet e shumë çështjeve tjera dhe nuk mund të ketë qasje në ta. Kështu pra, i lejohet ixhtihadi në to, ashtu siç i lejohet tjetrit. Kjo, dhe duhet pasur parasysh se duhet t'i plotësoj të gjitha kushtet që kanë të bëjnë me çështjen në të cilën bën ixhtihadë, siç e kemi sqaruar.

Të tjerët argumentohen me atë se: Është e mundur që ndonjëri të ketë njohuri të cekët (të pamjaftueshme), e atëherë atij i lejohet që të hulumtoj për atë dispozitë me atë dituri që ka (në bazë të kapacitetit të tij). Dijetarët janë pajtuar se, muxhtehidit nuk i lejohet argumenti i dispozitës derisa të peshoj mendimi i tij për të arritur atë që pikësynon pa pasur ndonjë pengesë, ndërsa këtë e arrin vetëm muxhtehidi absolut dhe në këtë rast muxhtehidi nuk ka arritur në fazën në të cilën i peshon mendimi dhe në të cilën nuk ka pengesë.

Replikë: Ne presupozojmë se i ka arritur të gjitha elementet të cilat janë të ndërlidhura me atë çështje.

Disa autorë bashkëkohorë e favorizojnë drejtimin e këtyre¹⁰² sepse ixhtihadi është kompetencë dhe aftësi e caktuar për të kuptuar shpirtin e shariatit dhe parimet e përgjithshme të saj, e ajo është sikurse në oratori, njeriu nuk mund të jetë orator përderisa nuk i plotëson të gjitha lëmit e të shprehurit, ashtu që secilën fjalë e praktikon dhe e përdor ashtu siç e kërkon rasti dhe nevoja.

Nuk mund të paramendohet që një dijetar të jetë muxhtehidë në ligjet e shkurorëzimit dhe të mos jetë muxhtehidë në ligjet e shitblerjes, ose muxhtehidë në ligjet e dënimeve penale dhe të mos jetë muxhtehidë në ligjet e adhurimeve pasi ligjet e shariatit janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Padijenja në disa prej tyre sjell mëdyshjen se nuk ka aftësi dhe është i mangët edhe në temën e llojit në të cilën ka njohuri.¹⁰³

Mirëpo unë i jap përparësi drejtimin të shumicës së dijetarëve sepse ata e kanë paraparë domosdoshmërinë e plotësimit të kushteve të shariatit te

dijetari, e prej tyre, *njohja e objektivave të sheriatit*, sikurse kanë kërkuar njohurinë e cila ndërlidhet me temën e ixhtihadit, për këtë arsye nuk duhet të ketë pengesë në pjesshmërinë e ixhtihadit, posaçërisht nëse i shikojmë rrethanat bashkëkohore të cilat na kërkojnë të jemi në përputhje me realitetin.

Siç thotë Gazaliu, me rëndësi është që dijetari të jetë vizionar në atë që jep fetva, dhe që të jep fetva për atë që ka njohuri dhe e di se ka njohuri, dhe të bëj dallimin në mes të asaj që ka njohuri dhe asaj që nuk ka njohuri, dhe të përqendrohet në atë që ka njohuri dhe të mos merret me atë për të cilën nuk ka njohuri.¹⁰⁴ Këtë koncept e kanë ata të cilët e lejojnë ixhtihadin e pjesshëm. Përfundimi i kësaj është se ai dijetar e ka kuptuar dhe e ka perceptuar të vërtetën me argument, dhe e ka shpenzuar energjinë për të kuptuar të drejtën. Në këtë, dispozita e tij është e njëjtë me dispozitën e muxhtehidit absolut.¹⁰⁵

Sipas perceptimit tim, mendimi për lejimin e ixhtihadit të pjesshëm ka qenë një dritare nga e cila kanë mundur të hyjnë dijetarë dhe kështu ta zbusin ekzagjerimin e atyre të cilët e kanë mbyllur derën e ixhtihadit duke zbritur në nivelin e paraqitjes së domosdoshmërisë ose të nevojës me të cilën janë ballafaquar dijetarët në çdo kohë për të dhënë fetva për dispozitën e ngjarjeve të paraqitura, të cilat deri në atë kohë nuk ka qenë, dhe përderisa në bazë të idesë së mbylljes së ixhtihadit nuk do të pranoheshin ato fetva, siç edhe do t'i sqarojmë. Për këtë arsye, favorizimi i drejtimit të atyre të cilët janë *për lejimin e ixhtihadit të pjesshëm* është çështje të cilën duhet vulosur në rend të parë.

El-Kjadhimi thotë: Sa i përket ixhtihadit të pjesshëm, nuk duhet sjellë dyshime se mund të ndodhë, sepse duhet shikuar në vet argumentimin e mendimit të tij, pra se çfarë argumente sjellë.¹⁰⁶

Përfundim – Papajftueshmëritë rreth çështjes së ixhtihadit nuk janë mendime të largëta ndaj njëra-tjetrës, por janë brenda një rrethi të afërt me njëra-tjetrën sepse te ata të cilët e lejojnë ixhtihadin e pjesshëm patjetër duhet që muxhtehidi t'i plotësoj kushtet e ixhtihadit, mirëpo nuk kërkohet që të plotësohet një kusht në tërësi, mirëpo mjafton që t'i plotësoj kushtet në përgjithësi, kushte të cilat kanë të bëjnë për një temë prej temave të caktuara.

Shkakun e mos pajtimit rreth kësaj çështjeje e ka sqaruar profesori Muhamed Tekijud-dijni ku thotë: *Ngatërrimi në mes të posedimit të ixhtihadit dhe të vepruarit me të është shkak se disa prej tyre i ngatërrojnë. Të vepruarit e pjesshëm nga posedimi i ixhtihadit është prej domosdoshmërive, bile posedimi i ixhtihadit është prej domosdoshmërive, bile në këtë aspekt nuk ka ixhtihadë absolut. Pretendimet se nuk mund të ketë ixhtihadë absolut në këtë aspekt pa tjetër se duhet të konceptohen, pasi që është i pamundur posedimi në të gjitha çështjet, deri edhe në ato tema të cilat ende nuk janë paraqitur. Për njeriun normal, përfshirja e të gjitha çështjeve të fikhut është e pamundur.*¹⁰⁷

Kjo nënkupton se, te një dijetar nuk është e patjetërsueshme posedimi i tërësishëm në mënyrën që ai t'i dijë praktikisht të gjitha çështjet dhe ta shfrytëzoj atë gjithmonë. Mjeku, pasi që të bëhet mjek, ai është mjek edhe poqëse nuk e shëron asnjë të sëmurë.

Tema e gjashtë: Kategoritë e Muxhtehidëve

Po e paraqes këtë çështje pasi që ndërlidhet me idenë e ixhtihadit, dhe me perceptimin e dijetarëve të mëvonshëm të cilët anojnë kah mbyllja e derës së ixhtihadit, dhe pasi shumica e fëmijëve tanë të kohës bashkëkohore interesohen për termin e ixhtihadit.

Sujutiu (ka vdekur në vitin 911 h.) ka thënë: Sot (për kohën e tij) shumica e njerëzve mendojnë se muxhtehidi absolut ka humbur që moti dhe se prej shumë kohësh ekziston vetëm muxhtehidi joabsolut. Ky mendim i tyre është gabim sepse ata nuk përqendrohen në mendimet e dijetarëve dhe nuk e kuptojnë dallimin në mes të muxhtehidit të pavarur dhe muxhtehidit të varur dhe nuk e dinë se në secilin lloj ekzistojnë edhe grupe.¹⁰⁸

Nga mendimi i tij dhe mendimi i Salahut dhe Nevevijut kuptohet se, ekzistojnë pesë kategori të muxhtehidëve dhe në përgjithësi ato kategori janë, ose muxhtehidë të varur ose të pavarur. Muxhtehidë të pavarur janë katër kategori, e këto kategori janë si në vijim:¹⁰⁹

1. Muxhtehidi i pavarur

Është muxhtehidi i cili vepron si i pavarur me rregullat e tij dhe ndërton perceptim të pavarur nga rregullat e medhhebeve të njohura.

Sujutiu (për këtë kategori) thotë: ***Kjo është një çështje që mungon për një kohë të gjatë, bile edhe po të dëshironte ndonjë njeri të vepronte ashtu, do ta kishte shumë vështirë.***

2. Muxhtehidi absolut por jo i pavarur

Është ai i cili posedon kushtet e ixhtihadit me të cilat cilësohet muxhtehidi i pavarur, por nga vetja e tij nuk zbulon rregulla, por e trason rrugën e imametit prej imamëve të umetit në ixhtihadë. Ai është absolut, por i varur, dhe nuk është i pavarur, dhe nuk është i përkufizuar sepse ai nuk e pason imametin e tij, mirëpo ai e trason rrugën e tij në ixhtihadë, si p.sh.:

- Ebu Jusufi, Muhamedi, Zuferi, - Hanefijë;
- Ibni Kasimi dhe Eshhebi, - Malikijë; dhe
- Buvejtii, Zëaferiu dhe Mezeniju, - Shafijë.

3. Muxhtehidi i përkufizuar apo muxhtehidi regjistruar

Është ai i cili përkufizohet në medhhebin e imametit të tij. Është i pavarur në konfirmimin e bazave të tij me argumente, mirëpo ai nuk del jashtë kornizave të argumentimeve të tij, bazave të tij, rregullave të tij dhe imametit të tij, si f.v.:

- Hasan bin Zijadi, Kerhiju, dhe Tahaviu, - Hanefijë;
- Ebheriu dhe Ibni Ebi Zejdi – Malikijë;
- Ebi Is'haku, Shijraziju dhe Mereziju, - Shafijë.

Ngjashëm me të lartpërmendurit janë autorët e ngjashëm me ta, mendimet e të cilëve prodhojnë efekte juridike në medhhebet e tyre të tekstualizuara nga imamët e tyre.

Kjo është kategori e *ixhtihadit të medhhebit* dhe këtu hyn ai i cili ka mundësi të përpiloj ligje, ngase i kupton ligjet për ngjarjet për të cilat nuk ka tekst nga imami i medhhebit, por ai i përpilon ligjet nëpërmjet rrugës së përpilimeve të teksteve apo rregullave të transmetuara nga imami i medhhebit, dhe po kështu bëhet edhe përpilimi për një çështje të cilën muxhtehidi jep fetva në dy raste të ngjashme me gjykime të ndryshme në kohë të ndryshme, dhe lejohet bartja e dispozitës dhe përpilimi nga njëri te tjetri dhe anasjelltas përderisa nuk ka dallim mes tyre ose nuk janë të afërt në hapësirë kohore në mes tyre.

4. Muxhtehidi vlerësues, favorizues i dispozitave

Është muxhtehidi i cili nuk e ka arritur kategorinë e dijetarit eminent, mirëpo - siç thotë Neveviju në librin “Mexhmuë” - Është fekihi i vetvetes dhe ruajtësi i medhhebit të imamt të tij, njohës i argumenteve të medhhebit të tij, konfirmues, sqarues, pasqyrues, analizues dhe miratues. Ai e tregon cila është e vërtetë dhe jo e vërtetë, dhe favorizon, mirëpo, ai përkufizohet nga tjerët (muxhtehidë), për shkak të mangësisë së ruajtjes së medhhebit, ose që e pëlqen mënyrën e përpilimit, ose që i kupton bazat dhe format tjera të ngjashme, si p.sh:

- Kuduriju, Merginaniju, i cili është autor i librit “Hidaje” të fikhut Hanefijë, dhe

- dijetari Halil, i fikhut Malikijë.

Kjo nënkupton se, ky muxhtehidë ka aftësi të favorizoj mendimin e imamt të medhhebit ndaj mendimit tjetër,

- ose që ka aftësi të favorizoj mendimin e Ebu Hanifes ndaj mendimeve të studentëve të tij ose të dijetarëve tjerë.

Çështja e tij është që ta favorizoj një transmetim ndaj një transmetimi tjetër.

Nëpërmjet këtyre muxhtehidëve, të cilët kanë ekzistuar në çdo kohë, është bërë e mundur fiksimi i dispozitave të shumta të fikhut, të transmetuar nga katër medhhebet, dhe përfitimi i arsyeshmërive të atyre dispozitave, derisa është bazuar analogjia në ato arsyeshmëri për çështjet për të cilat nuk ekziston tekst, pastaj perceptimi i mendimeve në të cilat duhet mbështetur dhe në të cilat nuk duhet mbështetur, po ashtu nëpërmjet tyre mund të plotësohen nevojat e njerëzve në përfitimin e ligjeve në kohë të ndryshme.

5. Muxhtehidi i fetvave

Muxhtehidë i fetvave është ai i cili përqendrohet në mësimin e një medhhebi, transmetimin e tij, perceptimin e çështjeve të qarta, mirëpo ai është i dobët për të bërë aprovimin e argumenteve të tij ose analizimin e tyre ose analogjinë e tyre.

Për këtë kategori, Neveviju thotë: ***Kjo kategori, transmetimet dhe fetvatë e tij i mbështetë në atë që e tregojnë librat e medhhebit të tij nga tekstet e imamet të tij dhe sqarimet sekondare të medhhebit të tij.***

Ky kategorizim është kritikuar¹¹⁰ për shkak se është quajtur *muxhtehidë* lloji i muxhtehidit të kufizuar në medhheb sepse i përkufizuari nuk arrin në nivelin e përfitimit të ligjit sheriatik, por arrin vetëm deri te mendimi i imamet (të medhhebit) të tij. Në këtë mënyrë bëhet një lëshim dhe të tre kategoritë e fundit konsiderohen se bëjnë ixhtihadë.

Malikijët deklarojnë se ekzistojnë tri lloje:

- muxhtehidi absolut,
- muxhtehidi i medhhebit dhe
- muxhtehidi i fetvave.

Muxhtehidë absolut: janë dijetarët e katër medhhebeve.

Muxhtehidi i medhhebit: është ai i cili ka mundësi të paraqes argumentet e medhhebit të tij, si f.v., Ibni Kasimi dhe Eshhebi.

Muxhtehidi i fetvave: është ai i cili di të vlerësoj, siç janë autorët e librave të medhhebeve.¹¹¹

Si i kategorizon Ibn Kajim el-Xhevziju muftitë?

Ibn Kajimi i ka përmendur llojet e muxhtehidëve apo të muftive në një formë tjetër, ai thotë: Ata të cilët e quajnë veten mufti janë katër llojesh:¹¹²

Lloji i parë: Ai i cili e di librin e Allahut, sunetin e të dërguarit të tij, di për mendimet e sehabeve. Ai është muxhtehidë i ligjeve të përbashkëta, që do të thotë, pajtueshmëria e argumenteve të sheriatit dhe ixhtihadi pasues i tij nuk bie ndesh me ixhtihadin e tjerëve. Çdo dijetar i umetit është pasues i atij i cili është më i ditur në disa ligje.

Për një çështje të haxhit, Shafiiju r.a. ka thënë: Këtë mendim e kam pasur nga Atau.

Kjo kategori ka të drejtë të jep fetva dhe pranohen fetvatë prej tyre dhe e kanë obligim të merren me ixhtihadë. Këta janë ata për të cilët pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Vërtetë, Allahu për këtë umet në çdo njëqind vjet dërgon dijetarë për të forcuar fenë e tij.”**¹¹³ Këta janë baza që Allahu i vendos për të forcuar fenë e Tij. Për ta, Ali bin Ebi Talibi, Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij, ka thënë: “Kjo tokë, nuk do të mbetet pa dijetarë të cilët sjellin argumente për Allahun.”

Lloji i dytë: Muxhtehidi i përkufizuar në medhhebin e tij, i ardhur prej tij. Ky është muxhtehidë në njohjen e fetvave, mendimeve, burimeve dhe bazave të medhhebit të tij, ai i cili ka mundësi të nxjerrë përfitime prej atyre argumenteve. Ky ka mundësi të bëjë analogimin e ndonjë çështjeje e cila nuk është në tekst me një çështje e cila veç ekziston në tekst, por pa qenë ndjekës i imamit të tij as në ligj dhe as në argumentim, por e përcjell rrugën e ixhtihadit dhe të fetvasë, dhe fton për medhhebin e tij, për vlerën e tij dhe vendimet e tij. Ai është në përputhje të qëllimit dhe rrugës së tij, si f.v., kadiu Ebu Jealij prej medhhebit Hanbelijë.

Lloji i tretë: Muxhtehidi i medhhebit të cilit i përket, i cili konfirmon me argument, i saktëson fetvatë, i njeh ato, mirëpo nuk del jashtë kornizës së mendimeve dhe fetvave të medhhebit të tij dhe nuk i kundërshton ato. Që në momentin kur të hasë në tekstin e imamit të tij, nuk lakon në ndonjë mendim tjetër asnjëherë. Kështu është çështja e shumicës së autorëve të librave të medhhebeve të imamëve të tyre. Kështu është gjendja e shumicës së dijetarëve të grupeve të caktuara.

Shumica prej tyre mendojnë se nuk ka nevojë ta dinë Kur'anin, as sunetin, dhe as gjuhën arabe, nga shkak se lejohet të veprohet me tekstet e imamit të vet. Te ata, ato tekste janë sikurse tekstet e Ligjvënësit. Për ta mjafton që të mundohen aq, dhe deri në atë masë të përjetojnë vështirësi, atyre u mjafton imami i cili i ka përfituar ligjet dhe ka përpiluar ligje prej teksteve. Ndonjëherë imami i tij e ka përmendur ligjin duke argumentuar me argument dhe i mjafton ai argument pa hulumtuar më tutje për të debatuar me argumentuesin e kundërt me të.

Kjo është çështja e shumë autorëve eminent dhe të drejtimeve dhe të autorëve të librave voluminoze dhe të autorëve të librave të thjeshtë. Këta as nuk pretendojnë se kanë bërë ixhtihadë dhe as nuk deklarojnë se janë pasues dhe ndjekës (të ndonjë medhhebi).

Ibn Kajimi i ka kritikuar, sepse (sipas Ibn Kajimit) ata kanë arritur nivelin e ixhtihadit në librin e Allahut dhe në sunetin e të dërguarit të Tij, dhe kanë mundësi të bëjnë përfitimin e ligjeve prej tyre dhe vlerësimin e asaj që e dëshmon teksti, e prapëseprapë e përkufizojnë veten në medhhebin e imamit, dhe e konsiderojnë imamin më të ditur se tjerët dhe konsiderojnë se imami i medhhebit është më meritues se sa tjerët që të pasohet dhe se medhhebi i tij ka përparësi dhe e vërteta është me të.

Lloji i katërt: Një grup e studiojnë fikhun e medhhebit të cilit i përkasin, dhe i mësojnë fetvatë dhe çështjet sekondare të atij medhhebi dhe ia përcaktojnë vetes që të pasojnë në mënyrë absolute në çdo aspekt. Këtyre, nëse u përmendet ndonjë ditë Kur'ani dhe suneti për ndonjë çështje, ai e bën si vlerë dhe si bekim dhe jo si argumentim dhe veprim. Kur sheh se Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Aliu r.a. dhe sehabet tjerë kanë dhënë fetva për një çështje dhe hasin se imami i medhhebit të tyre ka dhënë fetva të kundërt, e pranojnë fetvanë e imamit të medhhebit të tyre dhe e

anashkalojnë fetvanë e sehabës duke thënë: Imami është më i ditur se ne, ne e kemi pasur atë, ne nuk e anashkalojmë dhe nuk e llogarisim se ka gabuar, pasi ai është më i ditur se ne në drejtimin të cilin e ka marrë.

Përpos këtyre llojeve, i ngarkuari është i prapambetur. Ndoshta ai na thotë për veten e tij se është në nivelin e aktivistëve të kësaj fushe, por ai është i paaftë të arrij gradën e muxhtehidëve. Ai është kësisoj, anipse tregohet i aftë deri në një masë dhe pavarësohet në përgjigje. Thotë: Lejohet kushti i tij, i vlefshëm është kushti i tij, lejohet përderisa nuk ka ndonjë pengesë ligjore të sheriatit, dhe përgjigjet për ndonjë çështje në këshillimin e qeveritarit (udhëheqësit) dhe të tjerëve të ngjashëm, por prej përgjigjeve të cilat i llogaritet përgjigje të mira nga çdo i paditur, turpërohet prej tyre çdo njeri i ditur.

Tema e shtatë: Hapja dhe mbyllja e derës së ixhtihadit

Në shek. e IV hixhri Shteti Islam është ndarë në shtete dhe principata, gjë që e ka dobësuar Umetin Islam, dhe i ka shkëputur lidhjet politike ndërmjet tyre. Kjo ka ndikuar në ngurtësimin e aktivitetit shkencor dhe në dobësimin e pavarësimit të ideve. Dijetarët ranë në greminën e fanatizmit medhhebor, dhe humbën shpresat në vetvete. U shtuan polemikat dhe debatet, këndvështrimet, dhe shpërtheu xhelozia ndërmjet tyre dhe iu qasën materializmit. Njerëzit u sprovuan me gjykatës jokompetent. Dijetarët u përqendruan vetëm në regjistrimin e medhhebeve dhe në shkrimin e librave të thjeshta.

Disa dijetarë u frikësuan nga dobësimi dhe përçarja e fesë e cila do të shpinte në shkatërrimin e fikhut të qartë të cilin e kishin ndërtuar imamët e mëhershëm, andaj apeluan për t'iu përmbajtur medhhebeve të mëparshme dhe po ashtu apeluan për mbylljen e derës së ixhtihadit, për të mos lejuar në ixhtihadë dhe në përfitim të ligjeve ndërhyrjen e njerëzve jokompetent.¹¹⁴

Sipas mendimit tim, kjo është çështje e politikës së sheriatit, për të shëruar ndonjë çështje të veçantë, ose si çështjeje e përkohshme, ose mund të bëhet për shkak turbullimit të ixhtihadit e cila ndodh për shkak të ixhtihadit të pamjaftueshëm, por, kur të kalon problemi duhet kthyer në ligjin bazik, i cili quhet *hapja e derës së ixhtihadit*, edhe pse *në esencë* nuk ka mbyllje të derës së ixhtihadit, por ky është pretendim bosh dhe argument i rrjetës së merimangës, e cila nuk mbështetet në argument të sheriatit dhe argument logjik, por është vetëm iluzion.¹¹⁵

Disa dijetarë shiit deklarojnë se, mbyllja e derës së ixhtihadit ka ndodhur në shek. IV hixhrij.¹¹⁶ Pasi që më shumë se tre shekuj dera e ixhtihadit ishte e hapur, prodhimi ideorë u përkufizua dhe kësaj ligjësimi në sheriatë u ndërlidh me disa gabime për të cilat nuk ka arsyetim, ndërsa para kësaj kohe, buroi prodhimi ideor islam në fikh, në bazat e saj, të cilat janë burim i pashtershëm i ligjësimit islam në fikh dhe dijetarët i parapanë shkaqet në mënyrë të pandërprerë.¹¹⁷

Për këtë arsye them: Dera e ixhtihadit është e hapur për çdo intelektual, deri sa të mos ndalohet për të analizuar dhe studiuar, deri sa të mos ndalohet shprehja e talentit dhe liria e shprehjes, kështu që, nuk thuhet *rruga e*

ixhtihadit është e mbyllur dhe ka nevojë të hapet, pasi në esencë nuk e pranojmë se dera e ixhtihadit është e mbyllur edhe pse këtë e kanë thënë dijetarët e shek. IV h. dhe të tjerët pas tyre.

Me ixhtihadin e sodit, nuk nënkuptohet vetëm paraqitja e ideve të reja të ngjarjeve të reja, por gjithashtu nënkuptohet edhe vështirimi në vet argumentet pa u përkufizuar në vetëm një drejtim.

Për këtë arsye, shiitët ia kanë qëlluar nëse ata thonë për veten e tyre se kanë mbetur në bazën e *hapjes së derës së ixhtihadit absolut* për atë i cili është kompetent.¹¹⁸

Sujutiu në librin e tij¹¹⁹ i ka sjellë tekstet e dijetarëve të të gjitha medhhebeve, të cilët janë pajtuar me mendimin e obligueshmërisë së ixhtihadit dhe mospëlqimin e pasimit.

Dijetarët imam të medhhebeve kanë ndaluar që të pasohen ata dhe kanë kërkuar domosdoshmërinë e studimit dhe të hulumtimit, ashtu i kanë pasuar edhe dijetarët pas tyre. Ebu Muhamed el-Begaviju, si regjistruer i sunetit, në librin e tij *“Et-Tehdhibë”* (është prej librave më të njohur në fikh) ka thënë: **“Dituria është dy llojesh: Farz ajn (personal) dhe Farz kifaje (kolektiv)”**.

Pasi e përmend farzin ajn (personal) vazhdon e thotë: Farz kifaje (kolektiv) është që të mësohet për të arritur gradën e ixhtihadit në fushën e fetvave dhe gjykimeve, dhe të dilet nga sfera e pasimit, dhe për të mësuar (ixhtihadin) është obligim për të gjithë, mirëpo, nëse nga çdo anë studiojnë nga një apo dy, bie obligueshmëria nga të tjerët. Por, nëse asnjëri nuk bën ixhtihadë, nga shkaku se paaftësohen ligjet e sheriatit, që të gjithë bëhen mëkatarë.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمَا كَانَ الْمُؤْمِنُونَ لِيَنفِرُوا كَافَّةً ۚ فَلَوْلَا نَفَرَ مِن كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ

“Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në

diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehen tek ata, në mënyrë që ata të kuptojnë.”(Et-Tevbe : 122)²⁰⁰

Në librin “*El-Milel ven-Nihal*”, el-Shehrestaniu gjykon se, mëkatojnë pjesëtarët e një gjenerate nëse neglizhojnë ta kryejnë këtë farz. Për këtë gjykim, ai sjell argument logjik dhe të prerë, për të cilën nuk ka dyshim dhe thotë: *Me një fjalë, jemi të sigurt se ngjarjet dhe ndodhitë në adhurime dhe marrëdhënie të ndërsjella janë të panumërta dhe të pakufishme, dhe po ashtu e dimë në mënyrë të prerë se për çdo ngjarje nuk ka tekst dhe as që mund të pasqyrohet përderisa tekstet janë të kufizuara, dhe ajo çka është e pakufishme nuk mund të përkufizohet, atëherë mbetet ta kuptojmë se, ixhtihadi dhe kijasi janë obligim, ashtu që çdo ngjarje i nënshtrohet ixhtihadit.*²⁰¹

Mundësia e bërjes ixhtihadë dhe rëndësia e tij në kohën e sodit

Ixhtihadi është jeta e ligjësimi. Nuk mund të ekzistoj ligji përderisa fikhu dhe ixhtihadi nuk është i gjallë, refleksiv, aktiv²⁰² dhe në koordinim me të, pasi që prej kërkesave të lulëzimit dhe zhvillimit të jetës dhe domosdoshmërisë së përhapjes së sheriatit në botë është që të ekzistoj ixhtihadi dhe posaçërisht në kohën e sodit, e cila është epokë e konflikteve dhe paraqitjes së vështirësive të veprimeve reciproke dhe ripërsëritjen dhe paraqitjen e ngjarjeve dhe vështirësive të reja.

Kemi çështje të shumta të cilat kërkojnë zgjidhje me ligj të shëndoshë dhe këto nuk mund të zgjidhen pa ixhtihadë. Kjo është mënyra më e rëndësishme e të afuarit me Allahun e Lartmadhëruar sepse është pika qendrore në të cilën duhet përqendruar, në mënyrë që të ketë ligje për të treguar se sheriatu islam është i dobishëm për çdo kohë dhe për çdo vend.

Ixhtihadi duhet të aktivizohet pa frikë, brengat duhet lënë anash, duhet llogaritur se është i mundur realizimi i ixhtihadit me anë të hulumtimit të vazhdueshëm dhe në veprim me të, duhet zbuluar zinxhirët e studimit,

posaçërisht në çështjet të cilat paraqiten në këtë epokë, se përndryshe, pa kurrfarë dyshimi që të gjithë do të jemi mëkatarë, e për këtë që e them jap përgjegjësi para Allahut.

Përderisa, neglizhenca dhe ulja në vendin e përtacisë dhe të vetmjaftimit me atë që na ka ardhur prej fikhut islam dhe duke mbetur prapa trenit të kohës dhe të zhvillimit shkencor dhe të zgjerimit të fushave të fikhut botëror është diçka për të cilën nuk pajtohet Allahu dhe i dërguari i Tij. Muslimani i cili e do fenë e Allahut, nuk e pranon që t'i zbatoj ligjet me agoni.

Ixhtihadi është i mundur plotësisht! Në këtë nuk ka vështirësi, por me një kusht, që t'i varrosim iluzionet paradoksale dhe me shpërthimin e perdes e cila është e vendosur në mendjet dhe zemrat tona nga e kaluara dhe ngarkesa mbi supet tona. Është mëkat të paragjykohet se nuk mund të arrihet ajo të cilën e kanë arritur gjeneratat e para, thuaja se ajo është e pamundur. A ka çështje të pamundur, kur tashmë njeriu është ngritur në qiell dhe përdor satelitët në qiell, kur njeriu ka zbuluar atomin, rrymën elektrike dhe teknologjinë moderne?!

Mjerë për ne, po të ishin në kohën tonë personat si Ebu Hanife i cili ishte hero i lirisë së shprehjes dhe mendimit, sot a do të pajtohej ai me dijetarët dhe profesorët e universiteteve?!

Plotësimi i kushteve të ixhtihadit nuk është i vështirë, pasi që veç janë themeluar shkencat e ndryshme dhe janë shkruar shumë e shumë libra në ato lëmi dhe tashmë gjendet çdo gjë rreth atyre lëmenjve, mirëpo, nuk duhet mohuar faktin se ixhtihadi në gjetjen e bazave të reja dhe rregullave të reja duhet të jetë i pavarur, posaçërisht për përfitim, sepse sot kjo është fushë e saj.

Ne patjetër se duhet të udhëzohemi prej atyre udhëzimeve dhe ta përdorim mjetin të cilin e kanë njohur ato për të hyrë në thellësi të çdo çështjeje.

Dhe ja, kështu ne i shohim ata dijetarë të cilët në çdo kohë bëjnë ixhtihadë, i japin përparësi një mendimi të fukahave të mëhershëm derisa janë fiksuar medhhebet dhe janë përpiluar ligjet.

Thënia më e rëndë është thënia e Ibni Abdus Selamit, imam prej imamëve Malikijë, në librin e tij “Sherhul muhtesar li Ibni Haxhib” në kapitullin e gjykimeve, ku thotë: Niveli i ixhtihadit mund të arrihet dhe ky

është kusht për të cilën ka lajmëruar pejgamberi s.a.v.s., e ajo kohë është kur nuk do të ketë dituri dhe ajo kohë deri më sot nuk ka arritur, se përndryshe umeti ynë do të ishte pajtuar në gabim dhe kjo është e papranueshme.

Duke e komentuar këtë thënie Sujutiu thotë: ***Shiko si e ka deklaruar se niveli i ixhtihadit nuk është i pamundur, dhe se ajo ekziston deri sa koha e tij dhe se mungesa e tij (ixhtihadit) nënkupton se umeti janë pajtuar për mëkat dhe kjo është absurde.***²⁰³

Profesionet në të cilat kushtëzohet ixhtihadi

Ajo çka e vërteton mendimin se dera e ixhtihadit është e hapur domosdoshmërisht, është ajo që fukahatë kanë kushtëzuar për t'i plotësuar kushtet në pranimin e detyrave si në vijim.²⁰⁴

1. **Imami islam (halifja):** Fukahatë e kanë kushtëzuar që ai duhet të jetë muxhtehidi më i madh.

2. **Ministria zëvendësuese:** Është që të zëvendësoj imamin për planifikimin e çështjeve sipas tyre dhe realizimin e tyre në bazë të ixhtihadit të tij. Kjo ministri llogaritet taklidë (pasim) në kushtet e imamit.

3. **Gjykatë:** Malikijetë, Shafiijetë dhe Hanbelijetë, (kushtëzojnë) për të qenë gjykatës personi duhet të jetë muxhtehidë.

4. **Zëvendësgjykatësit dhe pasuesit e tyre:** Po ashtu edhe për këtë detyrë kushtëzohet që personat të jenë muxhtehidë.

5. **Muftiu:** Duhet të jetë muxhtehidë në medhhebin në të cilin jep fetva, njësoj sikurse muxhtehidi në sheriatë.

6. **Llogaritësi (Inspektori):** Është ai i cili urdhëron për të mirë kur nuk veprohet e mira dhe ndalon nga e keqja kur të paraqitet ajo.

Kadiju Ebu Jealij i ka përmendur këto dy alternativa në kushtëzimin e ixhtihadit për administratorin (inspektorin). Është vërtetuar se Mavrudi nuk i kushtëzon këto dy çështje.

Tema e tetë: Gabimi dhe mosgabimi në ixhtihadë

Për këtë çështje filozofike të vjetër, dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme, dhe mendimet përbëhen prej dy anëve:

Ana e parë: Në baza dhe në çështje logjike.

Ana e dytë: Në çështjet sekondare të fikhut.

Do të flas për të dy çështjet në dy aspekte:

- Aspekti i gabimit dhe mosgabimit në çështjen në të cilën bëhet ixhtihadë.
- Aspekti i dispozitës gabuese për të cilën mëkaton.

E para: Ixhtihadi në çështje logjike dhe në çështje të usulit.

Shumica e dijetarëve të usulit janë pajtuar se²⁰⁵ hulumtuesi, në çështjet logjike dhe të usulit, është e detyrueshme që të arrij te e sakta dhe e vërteta në to, sepse e vërteta është një dhe nuk ka tjetër, dhe e qëlluara është e vetmja dhe konkrete, nëse nuk ndodh kjo, atëherë janë bashkuar dy të kundërtat. Kush e ka qëlluar të vërtetën, e ka qëlluar, ndërsa kush e ka gabuar të vërtetën, ai ka mëkatuar. Lloji i mëkatit ndryshon. Nëse gabimi ka të bëjë me Allahun dhe të dërguarin e Tij, ai është pabesimtar, nëse jo, atëherë ai është mëkatar i madh dhe shpikës, sepse ai është shmangur nga e vërteta dhe ka humbur, si f.v. temat si, mos shikimi i Allahut të Lartmadhëruar (në Botën tjetër), krijimi i Kur'anit, krijimi i veprave (të njerëzve).²⁰⁶

Çështjet logjike, janë çështjet në të cilat studiuesi e kupton të vërtetën në bazë të logjikës para prezantimit të ligjit, si p.sh.:

- Vërtetimi i çështjes se, e krijuara patjetër se e ka Krijuesin.
- Cilësitë e Tij të domosdoshme të lejuara dhe absurde.
- Dërgimi i pejgamberëve dhe besimi në mrekullitë mbinatyrore të tyre.
- Krijimi i gjithësisë.
- Lejimi i mundësisë së shikimit të Allahut.
- Krijimi i Kur'anit dhe veprave.
- Dalja nga zjarri i atyre që besojnë në një Zot, dhe të ngjashme.

Çështjet e usulit. Shembull:

- Natyra e ixhmait,
- Natyra e kijasit,
- Argumentimi i lajmit të vetëm dhe tregueshmëria e saj e prerë, dhe ajo se, kundërshtuesi i saj është mëkatar.

Xhahidhi dhe Abdullah bin el Hasan el Anberiju nga muëtezilët, kanë thënë: *Muxhtehidi gabimtar në çështje logjike, nuk bën mëkat, përderisa nuk arrin në nivelin e inatit (mohimit), pra, nëse ai bën ixhtihadë në kundërshtim me fenë islame për (pro) jehuditë, krishterët dhe dehrijinët (ateistët), dhe ixhtihadi i tij e shpie në bindje të tillë, atëherë themi se ai nuk ka bërë mëkat, sepse ai është angazhuar me mundin dhe aftësinë e tij, me forcën dhe mundësinë e tij, prandaj ai arsyetohet.*

Anberiu ka shtuar edhe pasusin: “Në çështjet e logjikshme, çdo muxhtehidë ia qëllon:

- Nëse dëshiron ta gjej të vërtetën dhe ia qëllon, ai sjell atë për çka është i ngarkuar dhe atë çka është brenda mundësisë dhe aftësisë në ixhtihadë.”

I këtij mendimi të tij është edhe Xhahidhi:

“Nëse pikësynon bindjen e tij, dhe ajo bindje është në përputhshmëri me besimin e drejtë, atëherë ai do të ishte i palogjikshëm, sepse ai logjikisht nuk mund të besoj se pafillimësia e botës dhe krijimi i saj janë të vërteta,

tjetra, nuk mundet në të njëjtën kohë të pohoj ekzistencën e Krijuesit dhe mohimin e Krijuesit, dhe çështje tjera të ngjashme të cilat si çështje qëndrojnë vetvetiu, e të cilat nuk janë çështje të besimit.”

Nga ky mendim i Anberijut janë habitur muëtezilët sepse kjo nënkupton nivelizimin e jehudëve, krishterëve dhe të gjithë pabesimtarëve, me ixhtihadin e muslimanëve.

Thënien e tij e interpretojnë kësisoj, ata thonë se, ai ka pasur për qëllim të tregoj kundërshtimin e muslimanëve ndaj tyre në çështjet e besimit (kelamit), si f.v., çështja e shikimit të Allahut, krijimi i veprave, krijimi i Kur'anit dhe të ngjashme, sepse argumentet dhe informatat janë vështirë të kuptueshme, dhe pasi që argumentet e dyshimta sjellin kundërthënie, atëherë muxhtehidi e ka të vështirë të merret me ato çështje. Përderisa, për atë që muslimanët kanë dhënë mendime të ndryshme kundrejt feve tjera siç janë, jehudët dhe të krishterët, këto janë çështje për të cilat konkluzionin përfundimtar e japin pjesëtarët e fesë islame.²⁰⁷

Argumentet

Xhahidhi dhe el-Anbeiju janë argumentuar me Kur'an dhe me argument logjik.²⁰⁸

Argument nga Kur'ani:

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا

“All-llahu nuk ngarkon askënd përtej mundësive të veta.” (El-Bekare, 286)

Pabesimtarët janë treguar të paaftë në të kuptuarin e të vërtetës dhe i janë përmbajtur besimit të tyre nga frika prej Zotit, e kjo pasi u është mbyllur dera e njohurisë.

Replikë – Ne nuk e pranojmë se ata janë të paaftë për të kuptuar të vërtetën sepse Zoti ua ka mundësuar atyre këtë atëherë kur u ka dhënë mendjen dhe u ka ofruar argumente dhe u ka dërguar peygamber për t’ua tërhequr vëmendjen, ashtu që pas peygamberëve, prej Allahut nuk ka mbetur argument.

Argumenti logjik

Zoti i Lartmadhëruar është i mëshirshëm me robërit e Tij, është i butë me ta. Nuk i përket Zotit që t’i dënoj për atë që nuk kanë mundësi, për këtë arsye, muxhtehidët nuk kanë mëkat për ligjet dytësore të ixhtihadit pasi ata e kundërshtojnë njëri-tjetrin në ato çështje me bindjet e tyre, bazuar në ixhtihadin e tyre me të cilin kanë arritur deri te ai përfundim.

Replikë – Nuk ka mëkat për ixhtihadin e çështjeve të fikhut, sepse qëllimi me to është se janë argumente të pasigurta, e që në esencë e kundërta është në këtë rast, në *besim*, e në këtë çështje nuk duhet pasur hamendje apo pasiguri, por duhet pasur dituri bindëse, e kjo nuk është arritur prej tyre.

Pjesa dërmuese e usulistëve janë argumentuar me Kur’an, sunet dhe ixhmaë.²⁰⁹

Argument nga Kur’ani:

وَأَخْرَيْنَ مُّكْرَرَيْنِ فِي الْأَصْفَادِ

“Dhe të tjerët (djaj) që ishin të lidhur në pranga.” (Sad : 38)

وَذَلِكُمْ ظَنُّكُمُ الَّذِي ظَنَنْتُمْ بِرَبِّكُمْ أَرْدَاكُمْ

“Mendimi juaj i gabuar, të cilin e patët ndaj Zotit tuaj.” (Fussilet : 23)

وَيَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ عَلَىٰ شَيْءٍ ۖ أَلَا إِنَّهُمْ هُمُ الْكَاذِبُونَ

“Ditën kur All-llahu i ringjall të gjithë, e ata i betohen Atij, sikurse u betoheshin juve, dhe mendojnë (me atë betim) të arrijnë diçka. Pra ta dini, se ata janë me të vërtetë rrenacakët.” (Muxhadele : 18)

فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ

“Në zemrat e tyre ka sëmundje.” (El-Bekare : 10)

وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ

“E për ta ka dënim të madh.” (El-Bekare : 7)

وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ

“...dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit.” (Ali Imran : 85)

Këto argumente tregojnë se Zoti i Lartmadhëruar i ka kritikuar për besimin e tyre dhe u ka premtuar dënim për ato bindje, po të kishin pasur të drejtë arsyetimi, nuk do të ishin kërcënuar me dënim.

Argument nga suneti

Dihet se pejgamberi s.a.v.s. ka kërkuar nga pabesimtarët, jehudët dhe të krishterët, që ta besojnë atë dhe atë çka i ka zbritur atij, dhe dihet se ai s.a.v.s. i ka kritikuar për besimin e tyre.²¹⁰

Argument nga ixhmai

Gjithashtu edhe dijetarët e mëparshëm të fesë sonë janë pajtuar që t'u tregojnë pabesimtarëve se nuk janë në të drejtë, dhe kanë kërkuar që të largohen nga bindjet e tyre dhe ta pranojnë shpalljen e fundit qiellore.

Kritika për bindjen e pabesimtarëve është argument se ata janë gabim në besimin e tyre dhe se kanë bërë mëkat.

E dyta: Ixhtihadi në çështjet dytësore të fikhut

Çështjet dytësore të fikhut janë dy llojesh:

E para: Çështjet e prera të njohura si çështje të domosdoshme të fesë, që do të thotë janë të njohura nga vetë natyrshmëria, si f.v., obligueshmëria e pesë kohëve të namazit, obligueshmëria e zekatit, obligueshmëria e haxhit, agjërimit, pastaj ndalimi i prostitucionit, ndalimi i vrasjes, hajnisë, alkoolit, e të ngjashme, ligjet e të cilave njihen se janë ligje të prera prej Allahut. Këto çështje nuk kanë të bëjnë me atë se a duhet qëlluar apo nuk duhet qëlluar nëpërmjet ixhtihadit.

Gjykimi gabim në to se a mëkaton apo jo, është sikurse gjykimi në ixhtihadin e çështjeve logjike. Çdo muxhtehidë nuk mund t'ia qëlltoj, ndërsa e vërteta është një dhe nuk është e shumënumërt, kjo dihet, e ai i cili e arrin të drejtën ia ka qëlluar, ndërsa ai i cili e thotë të kundërtën, ka gabuar dhe ka mëkatuar. Nëse kundërshtohet dhe mohohet ajo çka është e domosdoshme në qëllimin e Ligjvënësit, si f.v., mohimi i ndalimit të

alkoolit, hajnisë, mohimi i obligueshmërisë së namazit dhe agjërit, **ai llogaritet pabesimtar.**

Mohuesi i këtyre çështjeve është pabesimtar sepse mohimi buron nga përgënjeshtuesi i ligjit, por nëse janë prej çështjeve që dihen kategorikisht nëpërmjet hulumtimit (studimit) dhe nuk janë prej ixhmait, mohuesi nuk është pabesimtar, **por ai llogaritet gabimtar dhe mëkatar.**²¹¹

E dyta: Çështjet e pasigurta të fikhut, të cilat nuk janë nga ndonjë argument i prerë. Këtu qëndron fusha e ixhtihadit. Në këto çështje, muxhtehidi nëse ia qëllon nuk mëkaton, por edhe nëse gabon (nuk ia qëllon) nuk mëkaton. Kjo është kështu edhe në bazë të atyre të cilët deklarojnë se ndonjëri ia qëllon dhe tjerët gabojnë, edhe në bazë të atyre të cilët deklarojnë se, e drejta është një e vetme.²¹²

Beshrul Mursiji, Ebu Bekril Esami dhe Ibni Ilijeti dhe mohuesit e Kijasit, si f.v., dhahirijtë dhe imamijtë, thonë se, në çështjet sekondare, muxhtehidët nëse gabojnë, mëkatojnë, por ai ka të drejtë të konkretizoj, dhe ai ka të bëjë me argumentim të prerë, dhe ai i cili gabon, ai është mëkatar por nuk është jobesimtar dhe nuk është mëkatar i madh.

Këtë mendim e replikojnë në dy aspekte:

E para: Kjo çështje, është çështje e pasigurt dhe nuk tregon asgjë në vetvete, dhe në të nuk ekziston argumenti i prerë.

E dyta: Janë pajtuar sehabet që ta neglizhojnë mendimin e atyre të cilët kundërshtojnë çështje të fikhut, si f.v., trashëgimia e gjyshit me vëllezërit, çështja e Aulit, dhe çështjet tjera të trashëgimisë, etj., për të cilat çështje janë konsultuar dhe janë ndarë në mendime të ndryshme dhe nuk e kanë kundërshtuar njëri-tjetrin dhe asnjëri nuk e ka penguar tjetrin që të jap fetva publike, nuk i kanë penguar të rëndomtit që të i pasojnë, nuk i kanë ndaluar që të gjykojnë me ixhtihadin e tyre.

Kjo dhe, siç thotë Gazaliu: “Nuk ka dyshim se na është përcjellë në mënyrë të sigurt, edhe pse ata kanë argument të prerë, ekzagjerojnë me cilësimin për mëkatim dhe tregohen shumë rigoroz, siç janë treguar rigoroz

havarixhët me mëkatbërësin dhe siç janë treguar rigoroz sehabet me penguesit e zekatit.²¹³

Sa i përket gabimit dhe mosgabimit në ixhtihadë për çështjet dytësore, dijetarët kanë polemizuar gjatë dhe neve na janë raportuar mendimet e shumta kundërthënëse, por mjafton që t'i sqaroj dy mendime të njohura.

Mendimi i drejtë dhe mendimi i padrejtë

Mendimi i drejtë – Janë ata të cilët thonë se secili muxhtehidë ka gjykuar drejtë me ixhtihadin e tij.

Mendimi i padrejtë – Janë ata të cilët thonë: Njëri nga muxhtehidët gjykon drejtë, ndërsa të tjerët gabojnë, sepse e drejta është një, e nuk mund të jetë e shumëfishtë (shumënumërt).

Imam Ahmedi thotë: Tek Allahu, e drejta është një, dhe nuk mund t'ia qëllojnë të gjithë muxhtehidët, mirëpo ai i cili ia qëllon ka dy shpërblime, e ai i cili nuk ia qëllon ka vetëm një shpërblim, kjo nga shkaku se e ka kërkuar të drejtën por nuk e ka arritur.

Gjeneza e këtij mospajtimi është në atë se, a ka paraparë Allahu i Lartmadhëruar ligj konkret para ixhtihadit të muxhtehidit apo nuk ka paraparë ligj konkret, por ligji për atë çështje caktohet kur muxhtehidi e finalizon çështjen me ixhtihadin e tij.²¹⁴

Disa thonë: Në atë çështje Zoti i Lartmadhëruar ka paraparë ligj konkret në lejim apo në moslejm, hallall apo haram, por te Allahu ai ligj përcillet në mendjen e muxhtehidit, ata janë të cilët thonë se çdo muxhtehidë ia qëllon, *këta janë Esharijtë, muëtezilët, kadiu el-Bakilaniu, dy studentët e Ebu Hanifes dhe Ibni Serijxhi.*

Të tjerët thonë: Para ixhtihadit, Zoti i Lartmadhëruar ka paraparë ligj konkret për secilën ngjarje, ai i cili me ixhtihadin e tij ia qëllon, ai ia ka qëlluar, ai i cili nuk ia qëllon ai ka gabuar. Njëri ia ka qëlluar, të tjerët kanë gabuar, vetëm se këta nuk kanë rënë dakord se ai ligj a ka ndonjë shenjë që dihet (kuptohet) se është e drejtë apo jo. Për këtë çështje ekzistojnë këto mendime:

1. **Një grup i fukahave dhe mutekeliminëve thonë:** Ky ligj as nuk ka argument dhe as shenja, por është çështje me dy anë, të cilat studiuesi i ka gjetur dhe dëshiron t'i niveloj, andaj kush e gjen ai ka dy shpërblime, kurse kush i gabon ai ka një shpërblim. Për mendimin tim kjo është e pakuptimtë.

2. **Disa thonë:** I paraprijnë këtij ligji shenjat hamendësuese, muxhtehidi nuk është i ngarkuar për t'ia qëlluar argumentimit për shkak të përgjithshmërisë dhe fshehtësisë, dhe ai i cili nuk ia qëllon arsyetohet dhe shpërblehet. Ky është mendim i fukahave, e për mendimin tim, ky është mendim i drejtë sepse është e pasinqertë që i logjikshmi të ngarkohet me ligj i cili nuk ka as argument dhe as shenja, posaçërisht kur ixhtihadi është të shpenzuarit e energjisë, e duke e kërkuar ligjin me argument, ai detyrohet që të kërkoj argumentin me të cilin argumenton, kërkitimi i një çështjeje është më e vonshme se vet çështja.

3. **Të tjerët thonë:** Këtij ligji i paraprijnë shenja të prera (të sigurta) dhe muxhtehidi është i urdhëruar ta hulumtoj këtë argument, por ai i cili nuk ia qëllon, ai nuk bën mëkat dhe nuk kritikohet gjykimi i tij, për shkak të fshehtësisë dhe turbullirës së argumentit.

4. **Beshrul Murijsi thotë:** Ai i cili nuk ia qëllon, bën mëkat dhe nuk arsyetohet, çështja është e njëjtë sikurse me ligjet e prera.

5. **El-Esemi ka thënë:** Gjykimi i tij kritikohet.

Pa marrë parasysh këto mospajtime të pjesshme, do ta sqaroj mendimin për ata që mendojnë se duhet arritur gjykimin e drejtë, dhe mos arritjes së gjykimit të drejtë.²¹⁵ Duhet ta kuptojmë se, mospajtimi ka të bëjë në shikimin e ixhtihadit dhe finalizimin e ligjit prej argumentit, përderisa, nëse

shikojmë në veprën në të cilën ka rezultuar ixhtihadi i muxhtehidit, nuk ka dyshim se ai është ligj i Allahut me të cilën ka rezultuar ixhtihadi i muxhtehidit, nuk ka dyshim se ai ligj është ligj i Allahut, e me të janë të ngarkuar të gjithë.

Sa i përket në veprën e qëlluar, çështja është e qartë.

Sa i përket në veprën e paqëlluar, secili muxhtehidë mendon se, kundërshtari ia ka qëlluar me veprën në bazë të mendimit të vet edhe pse nga ana e kundërshtimit shihet si gabim, dhe secili muxhtehidë është i urdhëruar me atë që e ka rezultuar ixhtihadi i tij. Njësoj edhe pasuesi i tij. Papajtueshmëria është vetëm papajtueshmëri e pastër teorike. E vërteta në çështjet e ixhtihadit është e përhapur në mes të muxhtehidëve.

Mirëpo, sa i përket të vepruarit me atë mendim, ekziston papajtueshmëri në mes të Hanefijëve për rastin kur qëllohet e drejta, dhe te Shafijët kur nuk qëllohet e drejta, rastet si, kur dyshohet kibla dhe falësi bën ixhtihadë dhe falet në drejtimin në të cilin anon mendja e tij se në atë drejtim është kibla, pastaj sqarohet definitivisht se e ka gabuar drejtimin. **Te Shafiiju r.a.**, duhet ta përsërisë (ta falë kada) sepse e ka gabuar të vërtetën konkrete dhe të përcaktuar. Nëse nuk e përsëritë (nuk e falë kada) gabueshmëria nuk amnistohet nga mëkati, sikurse nuk amnistohet mëkati pa e paguar dëmin në çështjet e dëmshpërblimeve.

Te Hanefijët, nuk duhet ta përsërisë namazin, (ta falë kada) për shkak se gjykohet se ia ka qëlluar në të kaluarën edhe pse vërtetohet se ka gabuar në të kaluarën.²¹⁶

Mendimi se ia ka qëlluar

Pagabueshmëria: Esharijtë dhe muëtezilët, e raportohet edhe nga Hanefijët se, secili muxhtehidë ia qëllon (siç e sqaruam), mirëpo këta kanë dhënë mendime të ndryshme (janë ndarë në dy nëndrejtime):

- **Disa kanë thënë:** Në ngjarjen për të cilën nuk ka ligj konkret me tekst, kërkohet peshimi i mendimit, sepse ligji e pason mendimin dhe ligji i Zotit është te secili muxhtehidë te i cili ka peshuar mendimi i tij për atë çështje. *I këtij nëndrejtimi është el Kadiju Bakilaniu dhe Gazaliu dhe njihet si qëllimi i së drejtës Esharite.*

Kjo është ajo e cila është thënë për Hanefijët se ata janë deklarues për mendimin e qëlluar, por e vërteta e tregon të kundërtën sepse ata janë deklarues të mendimit jo të qëlluar. Sepse transmeton Tahaviju në “Imlaë” nga Muhammed bin Hasani se ky ka thënë: Ka gabuar ai i cili ka thënë për to (Hanefijët) atë çka vet e ka menduar, sepse ata (Hanefijët) mendojnë se: E drejta është tek Allahu i Lartmadhëruar, dhe se të gjitha çështjet janë NJË.²¹⁷

Të tjerët prej tyre thonë: Te Allahu, çdo ngjarje e ka dispozitën (ligjin) te e cila drejtohet kërkesa, pasi që patjetër se e kërkuara e ka Krijuesin, por muxhtehidi nuk është i ngarkuar për t’ia qëlluar. Të këtij mendimi janë muëtezilët dhe njihet si *e qëlluara muëtezilite*.

Sa i përket *mosqëlluarjes* – janë pajtuar se çdo ngjarje e ka dispozitën e përcaktuar prej Allahut të Lartmadhëruar, siç e kam sqaruar edhe më herët.²¹⁸

Argumentet

Argumentet se çdonjëri ka mendim të drejtë

Ata të cilët thonë se secili muxhtehidë e ka mendimin e drejtë, argumentohen si në vijim:²¹⁹

1. **Argument nga Kur’ani** – Me veprimin e Davudit dhe Sulejmanit a.s. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَكُلًّا آتَيْنَا حُكْمًا وَعِلْمًا

“Dhe secilit prej tyre i kemi dhënë dituri dhe aftësi gjykimi. (El-Enbija,79)

Po të mos ia kishte qëlluar njëri, atëherë nuk do të ishte në ajet paralelisht dituria e Allahut dhe gjykimi i tyre.

2. Argumentet nga suneti

Siç thuhet në gjurmim të hadithit se Muhamedi a.s. ka thënë: **“Es’habet e mi janë si yjet, në çdonjërin prej tyre që mbështeteni do të jeni të udhëzuar.”** Pejgamberi s.a.v.s. ka paraparë udhëzim në mbështetje të secilit prej sehaveve edhe pse ata japin mendime të ndryshme dhe gjykojnë në kundërshtim me njëri-tjetrin, si në aprovim apo mohim. Nëse ndonjëri prej tyre nuk ia qëllon, mbështetja në ta nuk do të ishte udhëzim i drejtë, por humbje.

3. Argument i ixhmait

Janë pajtuar sehabet se, mund të realizohet kundërshtimi i njëri-tjetrit dhe asnjëri nuk e ka mohuar këtë realitet, dhe prejudikojmë gabim nëse mendojmë se në ixhtihadë të tyre nuk do të merrej parasysh mendimi ndryshe, pasi ata e kanë lënë të lirë mendimin e mohimit të zekatit dhe mohimet tjera të ngjashme. Dhe kur ndonjëri prej tyre pyetet për ndonjë çështje, e dërgonte pyetësin te tjetri dhe e orientonte te tjetri. Kjo tregon se, ata janë pajtuar se secili muxhtehidë është mendimdrejt.

4. Argumenti logjik

Ka shumë argumente të kësaj natyre, më e rëndësishmja është: Po të ishte e drejta e përcaktuar (konkretizuar) në çështjet e ixhtihadit dhe në secilën çështje, Allahu do të na tregonte për secilën çështje me argument të prerë për t'i larguar mëdyshjet, ashtu siç janë përpiluar kërkesat prej Ligjvënësit, siç thotë Zoti i Lartmadhëruar:

رُسُلًا مُّبَشِّرِينَ وَمُنْذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ

“Të dërguar që ishin lajmëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të kenë fakt (arsyetim) para All-llahut.” (En-Nisa : 165)

Po të kishte qenë ligji i përcaktuar (konkretizuar) për një çështje, do ta siguronte që ligji i kundërt për atë çështje të jetë mëkat, sikurse është rasti te kundërshtimi i çështjeve logjike sepse ai është ligj në atë që nuk ka zbritur Allahu si ligj. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ

“E kush nuk gjykon sipas asaj që All-llahu e zbriti, të tillët janë mëkatarë të dalë jashtë rrugës së Zotit.” (El-Maide, 47)

Unë mendoj se këto janë argumente të dobëta sepse tregimi i ngjarjes së Davudit dhe Sulejmanit është kundërrargument për ta dhe jo argument i tyre sepse Zoti i Lartmadhëruar e ka konsideruar se Sulejmani ka gjykuar drejtë:

فَفَهَّمْنَاهَا سُلَيْمَانَ

“Dhe Ne ia bëmë që ta kuptojë atë Sulejmani.” (El-Enbija, 79)

Po të kishte qenë e drejta në secilin prej tyre Sulejmani nuk do të specifikohet në kuptim.

Sa i përket hadithit, siç kam treguar më herët, nuk është i saktë, po edhe nëse është i saktë, prapëseprapë ka kuptim të papërcaktuar sepse përgjithësimi i personave nuk nënkupton përgjithësimin e ngjarjeve. Mbështetja në të ka të bëjë me mbështetjen e transmetimeve të tyre nga pejgamberi s.a.v.s. dhe nuk ka të bëjë me mendimin dhe ixhtihadin e tyre. Hadithi nuk ka të bëjë me rastin në fjalë.

Po ashtu replikohet edhe argumenti logjik

E para: Nuk është e patjetërsueshme që Ligjvënësi të rregulloj vetëm urtësinë dhe interesin në ligjësi, ndonjëherë urtësia është specifikuar vetëm për diturinë e Allahut.

E dyta: Nuk është e patjetërsueshme që me urtësinë e një çështjeje të jetë vetëm një urtësi dhe kundërshtuesi të llogaritet mëkatar sepse muxhtehidi është i ngarkuar të veproj me atë që përfiton prej ixhtihadit dhe nuk është i ngarkuar të qëlloj të drejtën.

Po ashtu, replikohet mendimi i drejtë i thënë prej Esharijve dhe mendimi i drejtë prej muëtezilëve i thënë në mënyrë tjetër, posaçërisht i pari prej tyre. Nuk mund të pranohet pretendimi se ligji i Allahut pasohet në mendimin e muxhtehidit sepse në një pikë do të bashkoheshin dy të kundërtat - *siç do ta sqaroj te argumenti i shumicës absolute të dijetarëve më vonë* dhe mbi këtë rezultoj se, secili prej muxhtehidëve i cili është në kundërshtim me të tjerët në ligjësim ligji, ajo i përket edhe Allahut të Lartmadhëruar.²²⁰

Shevkaniju thotë: Nuk ka gjë më të rrezikshme se këta injorant çka kanë thënë se shumënumërsia e ligjit të Allahut është me shumënumërsinë e muxhtehidëve si pasim i cili prodhohet prej tyre me ixhtihadet e tyre. Thëniet dhe mendimet e tilla janë joetike ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe sheriatit të Tij të pastër. Po ashtu, është vetëm mendim iluzionar i paargumentuar dhe nuk ka as bazë në të cilën pushon mendja, po ashtu është në kundërshtim me ixhmain e dijetarëve të hershëm e të mëvonshëm sepse sehabet dhe të tjerët pas tyre gjeneratë pas gjeneratë gabojnë në ixhtihadin e tyre, gjë që është mirë të mbështeturit në ta.²²¹

Argumentet për gabimtarët

Shumica absolute e dijetarëve, e prej tyre Shafijijtë,²²² dhe sipas mendimit më të drejtë Hanefijtë, shiitët, argumentohen për gabimin²²³ në ixhtihadë, si në vijim:

1. Argument nga Kur'ani.

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

وَدَاوُدَ وَسُلَيْمَانَ إِذْ يَحْكُمَانِ فِي الْحَرْثِ إِذْ نَفَشَتْ فِيهِ غَنَمُ الْقَوْمِ وَكُنَّا لِحُكْمِهِمْ شَاهِدِينَ ﴿٧٨﴾ فَفَهَّمْنَاهَا سُلَيْمَانَ

“(Përkujto) Davudin e Sulejmanin kur pleqëronin për çështjen e bimës (mbjelljes) të cilën delet e atij populli e kishin kullotur natën, e Ne ishim përcjellës të gjykimit të tyre. E (përgjigjen e saktë) Ne ia mësuam Sulejmanit.” (El-Enbija : 78-79)²²⁴

Ky ajet tregon se Zoti i Lartmadhëruar e ka specifikuar Sulejmanin si kuptues të së vërtetës së ngjarjes, gjë që tregon të kundërtën për Davudin. Po të ishte ndryshe, nuk do të ishte përcaktuar Sulejmani. Kuptimdrejtë i kësaj ngjarjeje është vetëm njëri.

Replikë – Tregueshmëria e moskuptimit të Davudit a.s. është nëpërmjet rrugës së të kuptuarit të kundërt në ajet. Dhe kjo nuk është argument.

2. Argument nga suneti.

Thënia e pejgamberit s.a.v.s.: **“Kur gjykatësi gjykon me ixhtihadin e tij dhe ia qëllon, ai ka dy shpërblime, e nëse nuk ia qëllon ai ka vetëm një shpërblim.”**²²⁵

Hadithi është i qartë në ndarjen e ixhtihadit, i cili e ndan në *ixhtihadë kuptimdrejtë* dhe në *ixhtihadë kuptimgabim*. Po të ishte e drejta e shumënumërt, secili muxhtehidë do t’ia qëllonte, por kjo do të ishte në kundërshtim me hadithin.

Replikë – Kjo nuk është bosht i temës, nuk është ajo çka kërkohet prej pretenduesit sepse rezultatit të cilin e tregon hadithi është se disa muxhtehidë mund të gabojnë. Ata të cilët deklarojnë për kuptimdrejtët, kanë për qëllim për çështjen e cila është me tekst, kijasë ose kijasë të qartë dhe kjo në këtë rast nuk është bosht i temës.

Ngjashëm me këtë është hadithi: **“Gjykatësit janë tri llojesh, dy prej tyre janë në xhehenem, ndërsa një prej tyre në xhenet.”**²²⁶ Po të mos kishte qenë e drejta e vetme, ky klasifikim nuk do të kishte kuptim.

Më e qartë se kjo, është thënia e pejgamberit s.a.v.s. drejtuar udhëheqësit të rojeve të sigurimit: **“Nëse banorët e fortifikatës të thonë që të anashkalosh ligjin e Allahut, mos e anashkalo ligjin e Allahut, sepse ti nuk e di se a janë ata në të drejtën e gjykimit me ligj të Allahut apo jo.”**²²⁷ Sipas mendimit tim ky hadithë është tekst i boshtit të temës.

3. Argument nga ixhmai.

Sehabet janë pajtuar për përdorimin e fjalës “gabim” në ixhtihadë, si p.sh. thënia e Ebu Bekrit rreth çështjes së KELALES (trashëgiminë e bijve të axhallarëve): “Këtë e them në bazë të mendimit tim. Nëse ia qëlloj, atëherë është prej Allahut, por nëse nuk ia qëlloj, atëherë është nga unë dhe nga shejtani. Allahu dhe i dërguari janë të pastër për këtë çështje.”²²⁸

Umeri i ka thënë administratorit të tij: “Shkruaj: Ky është mendimi i Umerit, nëse është gabim është prej tij, nëse nuk është gabim është prej Allahut.”

Kur është paraqitur çështja e ngritjes së mehrit për mendimin e gruas ka thënë: **“Gruaja ia qëlloi (e dha mendimin e drejtë) ndërsa Umeri gaboi.”**²²⁹

Një grua e cila i vjen Umerit dhe i tregon se çka kishte në barkun e saj duke iu përgjigjur Uthmanit dhe Abdurrahman bin Aufit të cilët i kishin thënë Umerit: Ti je i edukuar, nuk shohim asgjë në këtë rast, e Umeri u ka thënë atyre: Nëse kanë bërë ixhtihadë kanë gabuar, nëse nuk ka bërë ixhtihadë, atëherë ju ka mashtruar. Mendoj se duhet ta paguash DIJEN (oj grua!).

Për çështjen e “*El-Mufevidatu*” Ibn Mes’udi ka thënë:²³⁰ **“Ky është mendimi im. Nëse është i drejtë është prej Allahut dhe të dërguarit të Tij. Nëse është gabim është nga unë dhe nga shejtani.”**

Kur në çështje të trashëgimisë, repektivisht për çështjen e AULIT nuk ia pranojnë Ibn Abasit, ai ka thënë: **“Kush dëshiron të më mallkoj, le të më mallkoj. Nëse dikush duhet të bëjë barazim të rezultatit, sepse 1/2, dhe 1/2 dhe 1/3. nuk del rezultati i pasurisë së njërit. Me këto dy herë nga 1/2 e harxhohet pasuria, e atëherë ku po mbetet vendi i 1/3?!**

(MUBAHELETU – është mallkim i cili është praktikuar në kohën e injorancës).”

Me këtë erdhëm deri këtu, te këto informata të cilat tregojnë se sehabet kanë paraparë mendimin e gabuar dhe mendimin e drejtë në ixhtihadë, dhe se e drejta është një dhe nuk ka tjetër.

Replikë ndaj këtij argumentimi nga ixhmai – Në të qëlluar, nuk mohohet se mund të ndodhë gabimi në ixhtihadë, por atëherë kur muxhtehidi nuk është kompetent në ixhtihadë, ose është kompetent në ixhtihadë por nuk e ka dhënë maksimumin e tij, ose e ka dhënë maksimumin mirëpo e ka kundërshtuar tekstin, ose ixhmain, ose analogjinë e qartë. Përderisa sa i përket kompletimit të ixhtihadit prej atij i cili është kompetent dhe nuk ka kundërshtim, ajo çka u përmend prej çështjeve të sehaveve nuk është diçka që tregon se është bërë gabim.

4. Argumenti logjik.

Ka shumë mënyra, por më e rëndësishmja është: Mendimi se muxhtehidët janë kuptimdrejtë shpie deri te mendimet e kundërta të muxhtehideve në mohim dhe vërtetim, ose të hallallit dhe haramit, ose të vlefshmërisë dhe të pavlefshmërisë së një çështjeje, në të njëjtën kohë edhe të bashkimit të dy të kundërtave në një vend dhe absurditet është që dy të kundërtat të kenë një ligj sepse kjo shpie në absurditet.

Replikë – Kontrastja realizohet nëse dy të kundërtat bashkohen në të drejtën e një personi, përderisa sa i përket për dy persona nuk ka të bëjë me kontrastin. Për këtë arsye, ngrënia e cofëtines lejohe për të detyruarin, ndërsa ndalohe për tjetrin. Ndërsa sa na përket neve, kur flasim për ixhtihadin, kemi të bëjmë me ligjin për lejimin i cili është bërë (në bazë të ixhtihadit) për një person, ndryshon ligji i cili është haram për personin tjetër, sepse ixhtihadi e ka rezultuar atë ligj të haramit.

Mendimi prioritar

E përkrahi mendimin e mundësisë së gabimit, në atë se Allahu ka paraparë ligj konkret në çdo çështje para ixhtihadit, dhe se ligji i posedon shenjat dhe se muxhtehidi është i ngarkuar që t'ia qëlltoj ligjit, dhe nëse ia qëllon, ai ka qëndrim të drejtë për të cilin shpërblehet dyfish, dhe nëse pas ixhtihadit nuk ia qëllon dhe gabon, ai është gabimtar për të cilin gabim nuk ka mëkat, por e meriton një shpërblim për shkak të angazhimit dhe shpenzimit të energjisë. Në sheriatë, e drejta është një e vetme. Muxhtehidi ia qëllon dhe gabon, e vërteta te Allahu është një sepse argumentet e sheriatit janë ose tekstuale ose analogji me ato tekste.

Papajtueshmëria në tekste: Kjo ndodh ose për shkak të interpretimit ose për shkak harmonizimit të saj nëse është sunet me hadithë të vetëm.

Sa i përket interpretimit: Në të, bazë është mendimi ndryshe i muxhtehidëve, sepse nga natyrshmëria ne e dimë se Ligjvënësi dëshiron kuptim konkret (të përcaktuar) nga teksti. Këtë kuptim e përfitojnë disa prej muxhtehidëve, ndërsa të tjerët mund të gabojnë, kush ia qëllon ai ka gjykuar drejtë dhe kush nuk ia qëllon ai ka gabuar.

Sa i përket mendimit ndryshe në lajme, varet prej kushteve të lajmit se si është lajmëruar, dhe në atë se si e përcjell muxhtehidi. Sa i përket të vërtetës në lajmin, ajo është e vetme, nuk është e shumënumërt. Lajmi, ose vërtetohet ose nuk vërtetohet. Të dyjat nuk mund të bashkohen në të njëjtën kohë për të njëjtën ngjarje. Kush e zbulon të vërtetën, ai ia ka qëlluar, të tjerët nuk ia kanë qëlluar.

Sa i përket analogjive, bazë e tyre është arsyeshmëria, që do të thotë, dobite për të cilat ka dashur Allahu të realizohen prej ligjeve dhe nuk ka dyshim se Ligjvënësi ka përcaktuar dobi konkrete dhe ai i cili e harmonizon ligjin e Allahut me arsyeshmërinë për të realizuar atë dobi konkrete, ai ia ka qëlluar dhe ka vepruar drejtë, ndërsa të tjerët kanë gabuar.²³¹

Çështja e autorizimit të muxhtehidit

Kjo çështje ka të bëjë me atë i cili ia qëllon dhe atë i cili nuk ia qëllon me ixhtihadë, dhe a lejohet që Zoti i Lartmadhëruar t'i thotë peygamberit apo muxhtehidit, *gjyko si të duash sepse sido që të gjykosh, ti je në të drejtë?*

Nuk ka kundërshtime në lejimin e autorizimit të peygamberit s.a.v.s. ose të muxhtehidit që të gjykoj në bazë të hulumtimit dhe ixhtihadit, por mospajtimi qëndron që në autorizimin e ligjësimit, pra në atë se a kanë të drejtë dijetarët të gjykojnë si dëshirojnë dhe si është e mundur të përputhet ligji i tij pa hulumtim dhe pa ixhtihadë?.

- Musa bin Imrani, dijetarë muëtezil thotë: Logjikisht kjo lejohet dhe absolutisht veçse ka ndodhur.
- Shumica absolute e dijetarëve Hanefijë thonë se nuk lejohet dhe se nuk ka ndodhur.
- El-Amediu thotë: Është e lejuar, por nuk ka ndodhur.
- Imam Shafiiu merr qëndrim neutral, për shkak të kundërshtimeve të argumenteve mes vete dhe mendon se asnjëri argument nuk është më prioritar se tjetri.²³²

Argumentet

Musa Ibn Imrani argumentohet me atë se, po të mos ishte e lejuar nuk do të kishte ndodhur, por pasi që veç ka ndodhur, atëherë është e lejuar. Argumentet se ka ndodhur janë si në vijim:

1. Argument nga Kur'ani

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

كُلُّ الطَّعَامِ كَانَ حَلَالًا لِّبَنِي إِسْرَائِيلَ إِلَّا مَا حَرَّمَ إِسْرَائِيلُ عَلَى نَفْسِهِ

“I tërë ushqimi ishte i lejuar për bijtë e israilit, përveç atij që Israili (Jakubi) para se të zbriste Tevrati ia ndaloi vetvetes.” (Ali Imran, 93)

Është bërë ndalimi prej vetes së tij, kjo tregon se ka qenë i autorizuar.

Replikë - Ajeti nuk është bosht i temës, sepse ky autorizim është për pejgamberin i cili është i siguruar nga gabimi dhe nëse gabon pejgamberi shpallja nuk do ta miratonte gabimin e tij.

2. Argumentet nga suneti

Ekzistojnë shumë fetva të cilat tregojnë se ka ndodhur autorizimi i tij për lejim dhe ndalim. Prej tyre, për çështjen e Mekës ka thënë: **“Mos i shkulni bimët mos i preni pemët.”**

Pastaj Ibn Abasi i thotë: “Përpos lloji trungut të IDHIRIT.”²³³

Pastaj pejgamberi s.av.s. për të mënjeluar vështirësinë nga banorët e Mekës thotë: “Përpos IDHRIT (lloj trungu).”

Kjo thënie nuk buron nga shpallja, sepse në kohë kaq të shkurtë dhe të kufizuar nuk ka mundur të zbres shpallja.

Pastaj thënia e pejgamberit s.a.v.s.: **“Po mos të frikësohesha se do ta ngarkoj umetin tim tejmase, do t’i urdhëroja përdorimin e misvakut para çdo namazi.”**²³⁴ Po të kishte qenë i paautorizuar, do t’i urdhëronte për përdorim të misvakut.

Rast tjetër – Kur Efre bin Habisi e ka pyetur pejgamberin s.a.v.s. për haxhin: **“A vetëm për këtë vit e kemi obligim haxhin, apo përgjithmonë? Muhamedi a.s. i thotë: Po të them po, do të obligohej dhe ju nuk do të kishit mundësi (ta kryeni haxhin për çdo vit).”**²³⁵ Ligjit ia ka shtuar në mes obligueshmërinë, lirimin, po mos të kishte qenë ligji i autorizuar për të pasur të drejtë zgjedhjeje, nuk do të kishte pasur vlerë fjala “po” për obligueshmëri.

Rast tjetër: Ajo çka transmetohet nga pejgamberi s.a.v.s. kur është vrarë en-Nadr bin Harithi prej robërve të Bedrit, dhe motra e tij Kutejlete bin Harithi, e thuri një poemë të gjatë si në vijim:

A Muhamedi është më i miri²³⁶ dhe më fisniku i popullit të tij?

Çka do të dëmtonte po ta amnistoshe,

se ndoshta amnistimi i djaloshit do të ishte zbutje e hidhërimit?

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Zoti e di më së miri. Po ta kisha ditur para ekzekutimit të tij, do të kisha bërë diçka.”²³⁷ Po të kishte qenë ekzekutimi i tij me urdhrin e Allahut, nuk do ta kisha kundërshtuar atë veprim.”** Gjë që tregon se ka qenë i autorizuar në çështjen e vrasjes.

Replikë ndaj argumentimeve të këtyre ngjarjeve të cilat u përmendën:

Çështja e tregimit të Israilit: Nuk është bosht i temës sepse ai rast është autorizim për pejgamberin, i cili është i mbrojtur nga mëkati me anë të shpalljes.

- Përrjashtimi i “DHIHRIT” (lloj trangu) është prej shpalljes së mëhershme ose prej ixhtihadit të pejgamberit s.a.v.s.
- Dispozita e *përdorimit të misvakut* është prej çështjeve për të cilat ka pasur të drejtë zgjedhjeje për të urdhëruar apo për të mos urdhëruar.
- Dispozita për robërit e Bedrit – Ka pasur të drejtë të zgjedhë në mes të ekzekutimit të robërve ose lirimit të tyre.
- Thënia “Po” për haxhin, kur e pyet Ekrea bin Habisi, është çështje e urdhëruar (mësuar) prej Zotit të Lartmadhëruar.

Argumentimi i muëtezilëve

Ligjet e Allahut janë për dobi të robërve, po të bartej autorizimi i ligjit të përzgjedhja e robit, ligji do të ishte në kundërshtim me dobinë sepse njeriu nuk e di cila është dobia prej ligjeve të Allahut, sepse mund të zgjedh çka nuk është e dobishme dhe kjo nuk lejohet, sepse është në kundërshtim me qëllimin e vendosjes së ligjit.

Amediju, për lejim, argumentohet me atë se nuk paraqitet absurditet, por po të presupozonim se mund të ndodhë vetvetiu, ose te tjetri. Kjo është e lejuar. Logjikisht lejohet. Argumentohet se nuk mund të ndodhë sepse duke përcjell ligjet vazhdimisht dhe në mënyrë permanente, shohim se nuk është hasur në diçka që tregon se ka ndodhur ligji prej autorizimit të pejgamberit apo muxhtehidit.

Rastet të cilat i tregon Musa bin Imrani, e kemi dëshmuar se, ose kanë ndodhur nga shpallja, ose nga ixhtihadi.

I jap përparësi mendimit se nuk është e drejtë që muslimani të thotë se lejohet që të autorizohet robi (njeriu) të gjykoj siç dëshiron dhe çka dëshiron, pa hulumtim dhe pa ixhtihadë. Njeriu nuk mund të dijë se çka dëshiron Zoti i Lartmadhëruar dhe nuk di për dobitë të cilat vijnë nga ligjet e Zotit të Lartmadhëruar.²³⁸

Tema e nëntë: Rruga e ixhtihadit

Nëse paraqitet një ngjarje e re, ose njeriu dëshiron të nxjerr mendimin final nga mendimet e të gjithë dijetarëve, dijetari muxhtehidë i përmbledhë të gjitha elementet e temës, duke filluar prej gjuhës (arabe), ajeteve të Kur'anit, hadithet, mendimet e dijetarëve të mëhershëm, format e analogjisë, pastaj e vështron ngjarjen pa fanatizëm të ndonjë medhhebi të caktuar, si në vijim:

1. Në rend të parë i shikon ajetet në librin e Allahut, nëse e gjen tekstin apo dukurinë, atëherë i përmbahet dhe merr vendim në bazë të kësaj.
2. Nëse nuk e gjen në Kur'an, shikon në hadithe,
3. Nëse gjen në hadithë, apo sunete praktike, apo miratuese, vepron sipas sunetit.
4. Pastaj shikon në ixhmain e dijetarëve.
5. Pastaj në kijasë dhe vepron në përfitimin e arsyeshmërisë, në bazë të ixhtihadit të tij duke vepruar në mënyrat e arsyes.²³⁹

Këto janë shtyllat e ixhtihadit, Kur'ani, suneti, ixhmai dhe kijasi.²⁴⁰ Në këto është përkufizuar Shafiiu, të tjerët shtojnë edhe të vepruarit me mendimin i cili përputhet me frymën e sheriatit islam.²⁴¹

Shafiiu thotë: ***“Pas pejgamberit s.a.v.s., Allahu askujt nuk i mundëson të dijë, përpos me diturinë që e mëson, e atë dituri e mëson prej Kur'anit, sunetit, ixhmait dhe gjurmimeve dhe prej rezultatit të Kijasit.”***

Po ashtu Shafiiju thotë:

Nëse muxhtehidit i paraqitet një ngjarje,

- ia paraqet teksteve të Kur'anit, nëse nuk e sheh aty,
- e paraqet te hadithet mutevatir,
- pastaj ia paraqet haditheve të vetmuara, nëse nuk e sheh aty, nuk e vështron në kijasë por i kthehet dukurive të Kur'anit,
- nëse hasë në dukuri, atëherë hulumton në specifikimet e kijasit dhe hadithit.
- Nëse nuk gjen ndonjë specifikim, gjykon ashtu. Nëse nuk gjen dukuri as në Kur'an dhe as në sunet, atëherë hulumton në medhhebe, nëse nuk gjen se janë pajtuar medhhebet, e pason ixhmain.
- Nëse nuk e gjen në ixhmaë (pajtueshmëri) atëherë i drejtohet kijasit dhe vështron rregullat e përgjithshme dhe u jep përparësi ndaj çështjeve dytësore, si f.v., vrasja me mjet të rëndë, i jepet përparësi rregullit të dëmtimit, nga aspekti i fjalës.
- Nëse nuk i gjen në rregullat e tërësishme vështron në të tekstualizuara dhe në tematikat e ixhmait.
- Nëse e gjen në kuptim të njëjtë, e bartë çështjen në të, nëse jo, atëherë i drejtohet kijasit.

Tema e dhjetë: Kundërshtimi i ixhtihadit

Para se të flasë për temën e kundërshtimit të ixhtihadit, duhet pasur njohuri për mendimet e shumta të muxhtehidit (për një çështje) dhe ndryshimit të ixhtihadit. Me fjalë tjera, a lejohet që muxhtehidi për një çështje t'i jep dy mendime? Pastaj, a lejohet ndryshimi i ixhtihadit?

1. Mendimet e ndryshme të muxhtehidit

Dijetarët kanë marrë vendim se nuk lejohet për një muxhtehidë që për një çështje, në të njëjtën kohë, për të njëjtin person, t'i jep dy mendime të kundërta, sepse kjo shpie në kundërthënie, dhe se, po të presupozonim se argumentet e të dy mendimeve janë të barabarta në forcën e tyre në çdo aspekt dhe këto dy argumente nuk mundemi as t'i bashkojmë dhe as të favorizojmë njërin ndaj tjetrit, atëherë muxhtehidi duhet të ndalet që të jep fetva (për atë çështje) për shkak të kundërshtimeve të argumenteve ndërmjet vete, dhe të baraspeshës së tyre në mes vete. Po të ekzistonte mundësia e bashkimit në mes të asaj çka rezultojnë të dy argumentet, duhet të bëhet bashkimi i tyre. Nëse favorizohet njëra ndaj tjetrës, përcaktohet se cila është favorizuar konkretisht, ashtu që thotë, ky mendim ka prioritet ose që e ndanë atë mendim ndaj tjetrit.²⁴²

Ky mendim është kundërshtuar me atë e cila është raportuar nga imam Shafiiu se ai shtatëmbëdhjetë çështje i ka gjykuar një herë ndryshe dhe herën tjetër ndryshe.

